



Funded by
the European Union



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



MACEDONIAN
CENTER FOR
INTERNATIONAL
COOPERATION



SELDI.net
Southeast European Leadership for
Development and Integrity

2023

RAPORT

**PËR VLERËSIMIN
E KORRUPSIONIT
NË MAQEDONINË
E VERIUT**



Funded by
the European Union



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



MACEDONIAN
CENTER FOR
INTERNATIONAL
COOPERATION



SELDI.net

Southeast European Leadership for
Development and Integrity

2023

RAPORT

PËR VLERËSIMIN
E KORRUPSIONIT
NË MAQEDONINË
E VERIUT

RAPORT PËR VLERËSIMIN E KORRUPSIONIT NË MAQEDONINË E VERIUT 2023

Titulli i orgjinalit: Извештај за процена на корупцијата во Северна Македонија 2023

Botues:

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN)

Redaktor:

Aleksandar Krzhhalovski, Drejtor

Autorë:

Jasmina Ristovska, Natasha Dimova, Snezhana Kamillovska Trpovska, Fanija Ivanovska dhe Jasmina Çausoska (QMBN)

Kontribut:

Misha Popoviq, Instituti për Demokraci Societas Civilis Shkup

Përkthim:

Vjosa Taipi

Lektura:

Daniell Medaroski

Dizajni:

Koma Lab.

ISBN: 978-608-4848-58-5

Shkup, 2024r.

CIP - Katalogimi në botim Biblioteka Nacionale dhe Universitare "Shën Kliment Ohridski", Shkup
343.352(497.7)"2023"(047)

RAPORTI për vlerësimin e korrupsionit në Maqedoninë e Veriut 2023 / [autorë Jasmina Ristovska, ... et al.]. - Shkup : Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN), 2023. - 78 f. : ilustrim; 25 cm

Gjithashtu në dispozicion në: <http://www.mcms.mk/>. - Shënimet në fund të tekstit. - Autorë: Natasha Dimova, Snezhana Kamillovska Trpovska, Fanija Ivanovska dhe Jasmina Çausoska

ISBN 978-608-4848-58-5

1. Ristovska, Jasmina [autor] 2. Dimova, Natasha [autor] 3. Kamillovska Trpovska, Snezhana [autor] 4. Ivanovska, Fanija [autor] 5. Çausoska, Jasmina [autor]

a) Corruption -- Maqedoni -- 2023 -- Raport

COBISS.MK-ID 63328261

Mendimet e shprehura këtu u përkasin autorëve dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Riprodhimi, kopjimi, transmetimi ose përkthimi i ndonjë pjese të këtij botimi mund të bëhet vetëm me lejen paraprake të botuesve, me qëllim citimin në një analizë të librit dhe në varësi të kushteve të përcaktuara në vazhdim.

E drejta e autorit e këtij botimi është e mbrojtur, por botimi mund të riprodhohet në çfarëdo mënyre pa pagesë për qëllime edukative. Për kopjimin në kushte të tjera, për përdorim në botime të tjera, ose për përkthim ose përshtatje, duhet të sigurohet leje paraprake nga botuesit.

Në formë elektronike, publikimi është i disponueshëm në www.mcms.mk dhe www.seldi.net

Ky publikim financohet nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Ky publikim është përgatitur nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar me mbështetjen e popullit amerikan përmes

Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Opinione të shprehura në këtë botim: Raport për Vlerësimin e Korrupsionit në Maqedoninë e Veriut 2023 u përket autorëve dhe nuk shpreh pikëpamjet e Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.


Përmbajtja

Lista e shkurtesave	5
Parathënie	7
Hyrje.....	8
Metodologjia.....	8
1. NIVELI I KORRUPSIONIT	10
1.1. Indekset e korrupsionit.....	11
1.2 Korrupsioni si problem shoqëror.....	12
1.3. Faktorët që ndikojnë në përhapjen e korrupsionit.....	13
1.4. Përvoja me korrupsionin.....	14
1.4.1. Vendime gjyqësore në lidhje me korrupsionin	14
1.4.2. Presioni korruptiv dhe përfshirja në korrupsion.....	15
1.5. Qëndrimet ndaj korrupsionit	18
1.5.1. Ndërgjegjësimi për korrupsionin	18
1.5.2. Pranueshmëria.....	20
1.5.3. Ekspozimi	21
1.6. Perceptimi i korrupsionit: Potenciali për parandalimin e korrupsionit	22
1.6.1. Probabiliteti për presion korruptiv	22
1.6.2. Prevalenca e korrupsionit (sipas profesioneve)	23
1.6.3. Korrupsioni në institucionet shtetërore (sektorët e rrezikuar).....	25
1.6.4. Zbatimi i politikave publike për luftën kundër korrupsionin	26
1.7. Besimi në institucionet kundër korrupsionit	27
2. POLITIKAT KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KUADRI LIGJOR	30
2.1. Strategjitë ekzistuese kundër korrupsionit, planet dhe programet e veprimit	31
2.2. Ligji i specializuar për antikorrupsionin	32
2.3. Legjislati kundër korrupsionit	33
2.4. Kuadri legjislativ për luftën kundër korrupsionit në gjyqësor	35
2.5. Instrumentet e tjera ligjore për luftë kundër korrupsionit.....	37
2.6. Rasti “Korridore”	39
2.7. Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit dhe parandalimi i korrupsionit në institucione	40

3. PRAKTIKAT INSTITUCIONALE DHE ZBATIMI I LIGJIT.....	42
3.1. Zhvillimet e përgjithshme institucionale	43
3.2. Institucionet e specializuara kundër korrupsionit.....	44
3.3. Mekanizmat kundër korrupsionit në proceset e vendimmarrjes	46
3.4. Roli i organizatave të shoqërisë civile në përgatitjen e kuadrit ligjor kundër korrupsionit ..	47
3.5. Organet e tjera të kontrollit shtetëror që kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit	48
3.5.1. Këshilli Inspektues.....	48
3.5.2. Enti Shtetëror për Revizion.....	49
3.5.3. Drejtoria e të Ardhurave Publike	50
3.5.4. Drejtoria Doganore	51
3.6. Prokurimet publike	51
4. GJYQËSORI DHE LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT.....	54
5. KORRUPSIONI DHE EKONOMIA	58
5.1. Situata në vend	59
5.2. Masat në luftën kundër ekonomisë informale	62
6. SHOQËRIA CIVILE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT	64
6.1. Aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile për antikorrupsionin.....	65
6.2. Mediat.....	66
7. BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR	69
Konkluzione.....	71

Lista e shkurtesave

BPV	Bruto prodhimi vendor
VMRO-DPMNE	Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas
GRECO	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
BDI	Bashkimi Demokratik për Integrim
ESHR	Enti Shtetëror për Revizion
KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
KSHZ	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
EShS	Enti Shtetëror për Statistikë
RVEKR	Regjistri i vetëm elektronik kombëtar i rregulloreve
LShF	Ligji për shoqatat dhe fondacionet
ACCMIS	Sistem informativ i automatizuar për menaxhimin e lëndëve gjyqësore (Automated Court Case Management Information System)
IRL	Laboratori i Raportim Investigativ
UNKAK	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit
QMBN	Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar
IFES	Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSHIA	Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
OKB	Kombet e Bashkuara
PTHP - NKOK	Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
KKP (kufizime kohore pasive)	Vlerësimi i ndikimit të rregullativës
P.P.	pikë të përqindjes
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
SÇE	Sekretariati për Çështje Evropiane
SMK	Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit
LSDM	Bashkimi Social Demokratik i Maqedonisë
PSP	Prokuroria Speciale Publike
DSK	Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim
DAP	Drejtoria e të Ardhurave Publike
QSD	Qendra për Studimin e Demokracisë
BQDhNH	Baza qendrore e të dhënave për ndihmë të huaj
RQRMV	Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut
AZZhB	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim



Parathënie

Raporti për vlerësimin e korrupsionit është një pasqyrë gjithëpërfshirëse e situatës dhe dinamikës së korrupsionit në Maqedoninë e Veriut. Baza e këtij raporti është Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit (SMK) i zhvilluar nga Qendra për Studimin e Demokracisë (QSD) nga Bullgaria. SMK u krye për herë të parë në Maqedoninë e Veriut në vitin 2001 në kuadër të analizës krahasuese të korrupsionit në Evropën Juglindore të zbatuar nga rrjeti i organizatave qytetare “Leadership për Zhvillim dhe Integritet në Evropën Juglindore (SELDI) (*Southeast Leadership for Development and Integrity - SELDI*). SMK bazohet në burime të ndryshme informacioni dhe kombinon metodat sasiore dhe cilësore për monitorimin dhe vlerësimin e korrupsionit. Kombet e Bashkuara (OKB) e kanë njohur SMK-në si një sistem të praktikave më të mira për monitorimin e korrupsionit në nivel kombëtar dhe është në përputhje me qasjen për viktimizim të OKB-së, për matjen e nivelit të korrupsionit administrativ. SMK bazohet në burime të ndryshme informacioni dhe kombinon metodat sasiore dhe cilësore të monitorimit dhe vlerësimit.

Raporti përbëhet nga shtatë pjesë. Pjesa e parë analizon nivelin e korrupsionit në Maqedoninë e Veriut bazuar në gjetjet e anketës të realizuar mbi popullsinë, në lidhje me perceptimin dhe përvojën me korrupsionin dhe në çështje të caktuara, të krahasuara me të dhëna dytësore. Në këtë pjesë, përmes shtatë indekseve, jepet një përgjigje për përvojën aktuale të qytetarëve me korrupsion, qëndrimet e tyre ndaj korrupsionit dhe perceptimet rreth korrupsionit. Politikat anti-korrupsion dhe kuadri ligjor janë prezantuar në pjesën e dytë, ndërsa praktikatat institucionale dhe zbatimi i ligjit janë përfshirë në pjesën e tretë. Tema e katërt e këtij raporti është roli i gjyqësorit në trajtimin e korrupsionit, ndërsa e pesta merret me mjedisin dhe ndikimin e efekteve të veprave korruptive mbi zhvillimin e ekonomisë. Pjesa e gjashtë dhe e shtatë kanë të bëjnë me shoqërinë civile dhe rolin e saj në luftën kundër korrupsionit, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mbështetjen për politikatat dhe masat kundër korrupsionit.

Raporti u përgatit nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) si pjesë e projekteve “Shoqëria Civile për Qeverisje të Mirë dhe Anti-Korrupsion në Evropën Juglindore: Ndërtimi i Kapaciteteve për Avokim të Bazuar në Dëshmi, Ndikim mbi Politikatat dhe Angazhim Qytetar (SELDI.net)”, mbështetur nga Komisioni Evropian dhe “Qytetarët kundër Korrupsionit”, mbështetur nga Agjencia e SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Aleksandar Krzalovski | Director | Macedonian Center for International Cooperation

Hyrje

Në kuadër të projekteve “Shoqëria Civile për Qeverisje të Mirë dhe Anti-korrupsion në Evropën Juglindore: Ndërtimi i Kapaciteteve për Avokim të Bazuar në Dëshmi, Ndikimi mbi Politikat dhe Angazhimin Qytetar (SELDI.net)” dhe “Qytetarët Kundër Korrupsionit”, QMBN publikon “Raportin për vlerësimin e korrupsionit në Maqedoninë e Veriut”.

QMBN përgatiti raport për vlerësimin e korrupsionit në vitet 2014 dhe 2016, si pjesë e programit të USAID-it kundër korrupsionit, në vitin 2018 si pjesë e projektit “Monitorimi i punës së KSHPK-së”, mbështetur nga Ambasada Britanike dhe në vitin 2019 dhe 2021 si pjesë e “Shoqërisë Civile për Qeverisje të Mirë dhe Anti-Korrupsion në Evropën Juglindore: Ndërtimi i Kapaciteteve për Monitorim, Avokim dhe Ndërgjegjësim Publik”, mbështetur nga Komisioni Evropian.

Raporti për vlerësimin e korrupsionit është një pasqyrë gjithëpërfshirëse e situatës dhe dinamikës së korrupsionit në Maqedoninë e Veriut. Metodologjia për përgatitjen e këtij raporti përdor burime të ndryshme informacioni dhe kombinon metodat sasiore dhe cilësore për monitorimin dhe vlerësimin e korrupsionit, përfshirë anketën me popullatën. Raporti përmban shtatë pjesë: niveli i korrupsionit, politikat, institucionet, gjyqësori, ekonomia, sektori civil dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.

Metodologjia


Raporti për vlerësimin e korrupsionit bazohet në metodologjinë e Sistemit për Monitorimin e Korrupsionit (SMK), zhvilluar nga Qendra për Studimin e Demokracisë (QSD) nga Bullgaria. Raporti analizon të dhënat parësore të marra nga anketa me popullsinë madhore dhe të dhënat dytësore.

Të dhënat parësore nga ky raport përdoren më së shumti në Kapitullin 1 – Niveli i korrupsionit, Kapitulli 5 – Korrupsioni dhe ekonomia dhe Kapitulli 6 – Shoqëria civile në luftën kundër korrupsionit.

Për dallim nga hulumtimet e mëparshme kur u krye anketë në terren, ky raund i SMK u krye përmes një ankete telefonike. Anketa telefonike u krye në një mostër përfaqësuese (në tekstin e mëtejme anketë me popullsinë) prej 1,017 të anketuarve, të kryer nga IPSOS midis 3 dhe 26 korrikut 2023. Kuadri i popullsisë së mostrës ishte një popullsi më e vjetër se 18 vjeç, ndërsa kriteret për përfaqësim ishin: gjinia, përkatësia etnike, mosha, vendbanimi dhe rajonet. Në kuadër të mostrës, 51% ishin gra dhe 49% ishin burra, ndërsa për sa i përket përfaqësimit etnik, maqedonasit u përfaqësuan me 68%, shqiptarët me 22%, grupet e tjera etnike u përfaqësuan me 10%. Për sa i përket vendbanimit, popullsia rurale u përfaqësua me 38%, ndërsa popullsia urbane me 62%.

Figura nr. 1.

Treguesit kryesorë të Sistemit për Monitorimin e Korrupsionit



Ky sistem lejon një krahasim dinamik të të dhënave nga monitorimit, të siguruara në vende të ndryshme dhe periudha të ndryshme kohore për sa i përket vëllimit, fushave dhe formave të korrupsionit. Ai përbëhet nga tre grupe treguesish që ofrojnë një pasqyrë të korrupsionit të grupuar zyrtarisht në shtatë indekse (përshkruar më hollësisht në pjesën 1 - Niveli i korrupsionit).

Raporti përdor shumë të dhëna dytësore, të tilla si: analiza e ligjeve dhe akteve nënligjore, strategjive dhe dokumenteve të tjera, raporte nga institucionet përkatëse dhe organizatat e shoqërisë civile. Një pjesë e të dhënave janë marrë nga organet e administratës shtetërore nëpërmjet kërkesave të paraqitura drejtpërdrejt për të dhëna me karakter publik. Qëllimi i të dhënave dytësore është të ofrojë një ide të mjedisit të përgjithshëm që ndikon në situatën me korrupsionin në Maqedoninë e Veriut, dhe mbi të gjitha, kuadrin ligjor dhe efikasitetin e institucioneve në disa fusha.

1.

Niveli i korrupsionit

Kjo pjesë e raportit bazohet në të dhënat parësore që merren nga analiza e popullsisë e përshkruar në metodologji dhe siguron bazën për SMK.

1.1. Indekset e korrupsionit

SMK ofron një pasqyrë sistematike të korrupsionit në vend përmes shtatë treguesve të bazuar në treguesit për korrupsion. Shtatë indekset formohen nga të dhënat e marra nga hulumtimi mbi perceptimin dhe viktimizimin e kryer në një popullatë me moshë madhore dhe ndahen në tre grupe:

1. **Përvoja aktuale me korrupsionin**
e cila përbëhet nga indekset e presionit dhe përfshirjes;
2. **Qëndrimet ndaj korrupsionit**
të analizuara përmes treguesve të ndërgjegjësimit, pranimit dhe ekspozimit; dhe
3. **Perceptimet për korrupsionin**
bazuar në indekset gjasat për presion dhe prevalencës së korrupsionit.

Të tre grupet e indeksit tregojnë ekuilibrin midis korrupsionit dhe antikorrupsionit në vend. Përvoja nxit perceptimet (presioni më i lartë aktual i korrupsionit shoqërohet me perceptime më të larta për prevalencë të korrupsionit) dhe qëndrimeve (përfshirja mund të rrisë pranimin), ndërsa nga ana tjetër, qëndrimet (ekspozimi) mund të konfirmojnë përvojën korruptive dhe perceptimet mund të formësojnë qëndrimet.

Figura 2.
Lidhja e ndërsjellë e treguesve për korrupsion



Source: State Statistical Office

Indekset për korrupsion në SMK mund të kenë një vlerë prej 0 (nuk ka korrupsion), deri në 100 (korrupsion absolut). Por interpretimi i vlerës ndryshon në varësi të faktit nëse përvoja dhe qëndrimet ose perceptimet do të merren parasysh. Në indekset për përvojën dhe qëndrimet, çdo vlerë mbi 5 është tashmë një tregues për problem të rëndësishëm korruptiv. Në indekset perceptuese, vlerat më të larta se 50 duhet të konsiderohen si problem serioz për korrupsion.

1.2 Korrupsioni si problem shoqëror

Qytetarët, për dallim nga vitet e mëparshme, e shohin korrupsionin si problemin më të madh social në vitin 2023 si dhe në vitin 2021. I dukshëm është fakti se 63.5% e të anketuarve në mënyrë të konsiderueshme më shumë se 46.1% në vitin 2021 renditën korrupsionin si problemin më të madh midis 11 opsioneve të ofruara.

Tabela nr. 1.

*Maqedonia e Veriut: problemet kryesore, 2018, 2019, 2021 dhe 2023
(përqindja e popullsisë që identifikoi faktorët përkatës si problem)*

Kategoria	2023	Kategoria	2021	Kategoria	2019	Kategoria	2018
Korrupsioni	63.5	Korrupsioni	46.1	Papunësia	41.2	Papunësia	47.1
Jo-stabiliteti politik	38.6	Papunësia	40.4	Të ardhura të ulëta	38.5	Jo-stabiliteti politik	38.6
Varfëria	25.5	Çmimet e larta	39.6	Jo-stabiliteti politik	34.0	Të ardhura të ulëta	36.4
Krimi	25.3	Të ardhura të ulëta	37.5	Korrupsioni	29.5	Varfëria	36.2
Të ardhura të ulëta	24.2	Varfëria	29.9	Varfëria	28.3	Korrupsioni	28.4
Mbrojtja shëndetësore	19.0	Jo-stabiliteti politik	24.5	Ndotja	27.7	Çmimet e larta	25.8
Papunësia	17.9	Krimi	21.6	Çmimet e larta	23.2	Krimi	20.5
Çmimet e larta	16.2	Mbrojtja shëndetësore	17.1	Krimi	20.4	Ndotja e mjedisit	18.6
Arsimi	14.0	Arsimi	11.6	Mbrojtja shëndetësore	12.6	Problemet ndëretnike	13.2
Problemet ndëretnike	7.8	Problemet ndëretnike	8.2	Problemet ndëretnike	11.3	Mbrojtja shëndetësore	10.6
Ndotja	6.0	Ndotja	6.8	Arsimi	6.7	Arsimi	5.1

Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Në vitin 2023, ka një ndërthurje të problemeve sociale dhe shoqërore në pesë vendet e para, kështu që pas korrupsionit, qytetarët identifikojnë jo-stabilitetin politik, varfërinë, krimin dhe të ardhurat e ulëta si problemet më të mëdha. Ajo që është veçanërisht e ndryshme nga vitet e kaluara është se mbrojtja shëndetësore po ngjitet ngadalë në shkallën e problemeve.

Në vitin 2023, ashtu si në vitin 2021, problemet ndëretnike dhe ndotja si probleme konstatohen në dy vendet e fundit.


Duke marrë parasysh korrelacionin midis krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe duke i konsideruar të dy problemet si situata që kanë të njëjtin sfond dhe që kërkojnë masa përkatëse për çrrënjosjen e tyre, konkludohet se për qytetarët lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është larg në krye të problemeve shoqërore.

1.3. Faktorët që ndikojnë në përhapjen e korrupsionit

Për mbi 80% të qytetarëve të Maqedonisë, ekzistenca e një krize morale në shoqërinë tonë, pasuar nga joefikasiteti i sistemit gjyqësor në luftën kundër korrupsionit, dëshira për pasurim të shpejtë personal të atyre që janë në pushtet dhe mbrojtja e pamjaftueshme e personave që raportojnë korrupsion janë faktorët kryesorë për korrupsionin e përhapur gjerësisht. Shumica e qytetarëve besojnë se të gjithë faktorët, përveç që nëpunësit kanë paga të ulëta (shih Figurën 3), ndikojnë në përhapjen e korrupsionit.

Figura nr. 3.

Faktorët që ndikojnë në përhapjen e korrupsionit në Maqedoninë e Veriut, 2023



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Demografikisht, nuk ka dallime të rëndësishme në perceptimin se sa faktorë të caktuar ndikojnë në përhapjen e korrupsionit në Maqedoninë e Veriut.

Ajo që është e jashtëzakonshme është se si shqiptarët ashtu edhe maqedonasit kryesisht pajtohen për faktorët që ndikojnë në përhapjen e korrupsionit, ndërkaq vërehet një ndryshim i caktuar në qëndrimet vetëm në dy nga faktorët. Kështu, 57.3% të maqedonasve, kundrejt 47.6% të shqiptarëve, pajtohen se pagat e nëpunësve janë të ulëta, ndërsa për 71.8% të maqedonasve, kundrejt 81.3% të shqiptarëve, ligjet nuk zbatohen në Maqedoninë e Veriut.

66% e maqedonasve dhe 72.3% e shqiptarëve pajtohen me pretendimin se korrupsioni është një tipar specifik i kulturës sonë, ndërsa 78.6% e maqedonasve dhe 83.4% e shqiptarëve pajtohen me pretendimin se dëshira për pasurim të shpejtë personal të atyre që janë në pushtet është faktori kryesor për korrupsionin e përhapur gjerësisht.

Është interesante të theksohet se mbështetësit e VMRO-DPMNE-së (86.3%) dhe mbështetësit e BDI-së (80.0%), në krahasim me mbështetësit e LSDM-së (65.5%), besojnë se për korrupsion kontribuon dëshira për pasurim të shpejtë personal të atyre që janë në pushtet.

1.4. Përvoja me korrupsionin


Grupi i parë i treguesve që pasqyrojnë përvojën me korrupsionin, analizon tre aspekte. Së pari, është e nevojshme të merren të dhëna statistikore (dytësore) për numrin e dënimeve për vepra korrupsioni që më pas të mund të krahasohen me gjetjet e anketës me popullsinë, duke iu referuar presionit të korrupsionit dhe përfshirjes në korrupsion. Në fund të fundit, presioni i korrupsionit dhe përfshirja në korrupsion janë dy indekset që japin një pamje të plotë të përvojës aktuale me korrupsionin.

1.4.1. Vendime gjyqësore në lidhje me korrupsionin

Të dhënat nga Enti Shtetëror i Statistikave (EShS) tregojnë se numri i personave të shpallur fajtorë për shpërdorim detyre në Maqedoninë e Veriut varionte nga 90 në vitin 2010 në 75 në vitin 2020, 80 në vitin 2021 dhe 98 në vitin 2022.

Ka një prirje të jashtëzakonshme ndryshimi - midis vitit 2010 dhe 2020, ku mesatarja në katër vitet e para ishte 90 persona, duke arritur një kulm prej 193 persona në vitin 2014, dhe duke vazhduar të bjerë deri në 2018 në 92 persona, dhe më pak të dënuar 53 - në vitin 2019, ndërsa që nga viti 2020 ka shënon rritje të vazhdueshme. Numri i personave të dënuar për dhënie ose marrje ryshfeti është shumë i vogël. Ka një tendencë të dukshme të uljes së numrit të këtyre personave. Numri më i madh i personave të akuzuar për dhënien dhe marrjen e ryshfetit ishte 20 në vitin 2010 dhe më i vogël 3 në vitin 2018. Trendi i një numri të vogël të personave të akuzuar vazhdon edhe në vitin 2021 dhe 2022 me 4 persona të akuzuar në vit.


Figure 4.
Numri i personave të shpallur fajtorë për shpërdorim detyre dhe ryshfet (marrje dhe dhënie ryshfeti) (2010-2022)



Burimi: Baza e të dhënave Makstat ¹

Sipas të dhënave në figurën e mëposhtme, mund të bëjmë edhe krahasimin e numrit të të pandehurve me numrin e personave të shpallur fajtorë për marrje dhe dhënie të ryshfetit për periudhën 2017-2022 (sipas të dhënave të disponueshme në bazën e të dhënave Makstat).

Figure 5.
Numri i personave të akuzuar dhe numri i personave të shpallur fajtorë për ryshfet (marrje dhe dhënie ryshfeti)



Burimi: Baza e të dhënave Makstat ²

1.4.2. Presioni korruptiv dhe përfshirja në korrupsion

Për të kuptuar dinamikën e korrupsionit, SMK përdor presionin e korrupsionit, ose korrupsionin e mundshëm, përkatësisht sa njerëz do të paguanin ryshfet nëse do t'u kërkohet nga persona zyrtarë. Ky indeks matet sipas kontakteve me nëpunësit zyrtarë dhe kërkesa e tyre për t'u dhënë një shumë të caktuar parash, dhuratë ose për të bërë një shërbim. Presioni shoqërohet me një kërkesë të qartë (kërkesë eksplicite) ose sinjale (përmes shprehjeve ose shenjave kryesore) se nëpunësi zyrtar pret diçka në këmbim.


Hulumtimi tregon se 31.3% e qytetarëve ishin të ekspozuar ndaj presionit korruptiv, ndërsa 25.5% ishin të përfshirë në korrupsion. Kjo në fakt tregon një rënie të presionit të korrupsionit me 2.4 pikë të përqindjes (p.p.) dhe një rënie të përfshirjes në korrupsion me 7.4 p.p. në krahasim me vitin 2021.

Gjithashtu, dallimi midis presionit dhe përfshirjes në vitin 2023 shënon rritje, gjë që sugjeron edhe rritje të rezistencës ndaj korrupsionit.

1 Ibid.

2 Ibid.

Figure 6.
Presioni
korruptiv dhe
përfshirja në
korrupsion
% e shtetasve
me moshë mbi
18 vjeç të cilëve
u është kërkuar
të japin ose kanë
dhënë ryshfet
(para, shërbime,
dhurata) në vitin
e fundit



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Tabela nr. 2.

Projeksionet e presionit dhe përfshirjes në korrupsion

	Rezultati i anketës	Numri i popullsisë (projeksioni)
Trysnia	31.3%	456.827
Përfshirja	25.5%	371.924

Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2022 dhe Projeksionet e Popullsisë për vitin 2022³ të Entit Shtetëror të Statistikave: baza e llogaritjes së popullsisë së rritur prej 1.461,223 persona


Pavarësisht uljes së presionit dhe përfshirjes, ky projeksion tregon se një pjesë e madhe e qytetarëve kanë përvojë me korrupsionin, përkatësisht pothuajse 460 mijë qytetarëve të rritur u është kërkuar ryshfet të paktën një herë dhe mbi 370 mijë qytetarë kanë dhënë ryshfet të paktën një herë gjatë vitit të kaluar. Projeksione të tilla tregojnë një përhapje të gjerë të korrupsionit administrativ.

Lidhur me përfshirjen në korrupsion, nëse supozojmë se këto janë raste individuale, flasim për një minimum të mundshëm prej 371.924 vepra të kryera. Nëse e krahasojmë atë me shumën e të personave të akuzuar në vitin 2022 për shpërdorim detyre dhe të personave të akuzuar për pranim dhe dhënie ryshfeti (gjithsej 98 persona), marrim një normë efikasiteti institucional prej 0.026%, përkatësisht kaq është përqindja e lëndëve që përpunohen, në krahasim me ato që supozojmë se po ndodhin.

Analiza e përfshirjes sipas asaj nëse ka pasur presion korruptiv apo jo, shënon përmirësim, krahasuar me vitin 2021. Në vitin 2023, çdo i pesti qytetar të cilit iu kërkua një kundërshërbim, dhuratë ose para, e bëri këtë, ndërsa 4,2% e qytetarëve kanë dhënë ryshfet, megjithëse nuk kanë përjetuar presion për ta bërë këtë.

3 Totali i vlerësuar i popullsisë rezidente të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjendja 31 dhjetor. PxWeb (stat.gov.mk)

Figure 7.
Përfshirja në
korrupsion me
ose pa presion
korrupsioni



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Për të përcaktuar dinamikën e korrupsionit administrativ, është e rëndësishme të perceptohet intensiteti i ndërveprimit të qytetarëve me administratën dhe në këtë mënyrë të përcaktohet presioni i korrupsionit. Në vitin e kaluar, 9,6% e qytetarëve u përballën me kërkesën e drejtpërdrejtë për ryshfet në secilin ose shumicën e rasteve të ndërveprimit, ndërsa për 15.8% të qytetarëve gjatë ndërveprimit ka pasur sugjerim nga nëpunësit administrativë se kanë pasur pritshmëri të tilla.

Këto të dhëna tregojnë një rënie të caktuar të presionit të korrupsionit të drejtpërdrejtë në krahasim me vitin 2021 kur 11,7% e qytetarëve u përballën me një kërkesë të drejtpërdrejtë për ryshfet, ndërsa vërehet një rritje e kërkesës indirekte për ryshfet në krahasim me vitin 2021 kur ka qenë 14.2%.

Rreth 40% e qytetarëve u përgjigjën se nuk kishin ndërveprim me administratën në vitin 2022.

Tabela nr. 3.

Intensiteti i presionit të korrupsionit (%)

Sa shpesh	Kanë kërkuar drejtpërdrejt para, dhuratë ose shërbim	Nuk kanë kërkuar drejtpërdrejt, por kanë treguar se prisnin para, dhuratë ose shërbim
Në të gjitha rastet	2.6	4.0
Në shumicën e rasteve	7.0	11.8
Në raste të izoluara	10.2	13.6
Në asnjë rast	40.4	30.8
Nuk ka kontakt/ nuk e di/ nuk ka përgjigje	39.7	39.7

Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Parë nga aspekti etnik, për dallim nga viti 2021, maqedonasit (37.6%) në numër më të madh se shqiptarët (22.8%) duhej të jepnin para, dhurata ose kundër-shërbim në të gjitha ose në shumicën e rasteve kur kishin kontakte me nëpunës zyrtarë në sektorin publik (shih Tabelën 4).

Tabela 4.*Përvojë me korrupsionin (%)*

		Mesatarja kombëtare	Maqedonas	Shqiptar
T'i japë para në dorë (para) nëpunësit	Në të gjitha rastet	3.1	2.1	7.0
	Në shumicën e rasteve	6.7	8.6	1.8
	Në raste të izoluar	13.9	12.3	21.1
	Në asnjë rast	75.1	76.0	68.4
	Nuk e di/ nuk ka përgjigje	1.2	1.0	1.8
T'i japë dhuratë nëpunësit	Në të gjitha rastet	3.6	2.7	5.3
	Në shumicën e rasteve	7.4	10.3	0.0
	Në raste të izoluar	17.9	14.2	33.3
	Në asnjë rast	70.5	72.1	61.4
	Nuk e di/ nuk ka përgjigje	0.6	0.6	0.0
T'i bëjë shërbim nëpunësit	Në të gjitha rastet	3.5	3.3	3.5
	Në shumicën e rasteve	8.6	10.5	5.3
	Në raste të izoluar	19.7	19.3	28.1
	Në asnjë rast	67.2	65.9	63.2
	Nuk e di/ nuk ka përgjigje	0.9	1.0	0.0

Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

1.5. Qëndrimet ndaj korrupsionit

Tre qëndrimet kryesore të nevojshme për të kuptuar dinamikën e sjelljes korruptive janë: ndërgjegjësimi për sjelljen korruptive dhe sa mirë qytetarët e kuptojnë dhe njohin se çfarë është korrupsioni, pastaj pranueshmëria, përkatësisht toleranca ndaj korrupsionit dhe ekspozimi ndaj korrupsionit.

1.5.1. Ndërgjegjësimi për korrupsionin


Të dhënat tregojnë se qytetarët kanë një nivel të lartë ndërgjegjësimi dhe për këtë arsye janë një burim i besueshëm për të nxjerrë konkluzione nga anketat e popullsisë. Qytetarët jo vetëm që njohin ryshfetin të dhënë në formë të parave, por njohin edhe forma të tjera më komplekse të korrupsionit, të tilla si nepotizmi, klientelizmi, etj. Kështu, kur u pyetën se cilat nga aktivitetet e mëposhtme janë shembuj të korrupsionit në të gjitha situatat e mësipërme, shumica e

qytetarëve i njohin ato si korrupsion. Shumica varion nga 61.7% në 90.6%, me indikacionin më të madh të dhënies së parave një nëpunësi policor për të mos revokuar patentën e shoferit, pastaj dhënia e parave/ kryerja e një shërbimi një nëpunësi administrativ për të marrë një telefonatë, koncesion ose prokurim publik, pranimi i parave nga një nëpunës administrativ për të miratuar evazionin fiskal ose lehtësimin fiskal, etj.

Megjithatë, pavarësisht se shumica e qytetarëve i njohin të gjitha aktivitetet e listuara si korrupsion, mbetet të theksohet se më shumë se një e treta e të anketuarve besojnë se nuk është korrupsion nëse një dhuratë i jepet një mjeku për t'i kushtuar më shumë vëmendje (36.3%), më pas më shumë se një e pesta besojnë se donacionet parazgjedhore të partive politike (23.4%) dhe kontakti personal me një anëtar të këshillit komunës të për të siguruar leje ndërtimi (22.0%) nuk përbëjnë korrupsion.

Figura nr. 8.

Ndërgjegjësimi për njohjen e korrupsionit në praktika të ndryshme të përditshme



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

1.5.2. Pranueshmëria


Numri i qytetarëve që nuk e miratojnë korrupsionin mbetet në të njëjtin nivel me vitin 2021, edhe atë me 4 p.p. më shumë se në vitin 2019 kur korrupsioni nuk është pranuar nga 59.2%. Sipas të dhënave nga kjo analizë, 62.9% e qytetarëve nuk i aprovojnë praktikat korruptive. Indeksi tregon shkallën në të cilën praktikat korruptive ose korrupsioni tolerohen në kuadër të sistemit të vlerave të shoqërisë. Duhet të theksohet se mos pranimi i korrupsionit nga qytetarët rritet nëse korrupsioni përfshin para.

Hulumtimi tregon se ndryshe nga hulumtimi i kaluar, pranueshmëria e një dhurate/ shërbimi/ dreke për personat udhëheqës në ministritë dhe komunat për të zgjidhur një problem personal është pothuajse e njëjtë për sa i përket pranueshmërisë që këtë ta bëjnë deputetët ose ministrat. Gjithashtu, sipas të dhënave, 90,0% e qytetarëve besojnë se është e papranueshme që personat udhëheqës në ministri dhe komuna, si dhe deputetët dhe ministrat, të marrin para në dorë për të zgjidhur një problem personal.

Nëse marrim parasysh format e ndryshme të praktikave korruptive dhe i krahasojmë me ata që nuk pranojnë aspak asnjë formë korrupsioni, do të marrim një raport prej 62.9% që nuk do të pranohet, krahasuar me 37.1% të personave që do të pranohet një sjellje të tillë, të ngjashme si në vitin 2021. Këto shifra janë inkurajuese për sa i përket hulumtimit në vitet 2016 dhe 2019, kur raportet ishin 52.8-47.2% dhe 59.2% -40.8%.

Gjenerata e re (18-29 vjeç) bëhet më pak tolerante ndaj korrupsionit në krahasim me valët e mëparshme të hulumtimit. Kështu, ndryshe nga vitet e kaluara, ky studim nuk vëren dallime veçanërisht të rëndësishme midis grup-moshave, gjë që shkon në drejtim të rritjes së përgjithshme të intolerancës ndaj korrupsionit. Këtë vit, mbi 80,0% e të anketuarve nga kjo grupmoshë i konsiderojnë të gjitha praktikat korruptive të papranueshme, gjë që i vendos në të njëjtin nivel me grupet e tjera.

Figure 9.
Pranimi i korrupsionit
% qytetarëve të moshës 18+ që pranojnë lloje të ndryshme korrupsioni




Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Nëse bëhet një projeksion sipas vlerësimit të fundit të popullsisë, për 540.653 qytetarë në Maqedoninë e Veriut korrupsioni është një mënyrë e pranueshme e sjelljes. Megjithatë krahasuar me hulumtimet e mëparshme numri ka rënë, madhësia e kësaj shifre, ende paraqet një problem të rëndësishëm në zhvillimin e politikave antikorrupsion, pasi sjellja korruptive mund të shfrytëzohet lehtësisht nga faktorët politikë ose të biznesit.

1.5.3. Ekspozimi


Indeksi i ekspozimit mat prirjen e qytetarëve për të kompromentuar vlerat e tyre nën presionin e rrethanave, përkatësisht kur përballen me situata reale jetësore, të cilat kërkojnë prej tyre të marrin një vendim nëse do të përdorin korrupsionin apo jo, duke ditur se do të ketë pasoja të drejtpërdrejta për atë që ka marrë vendimin. Ky indeks është një grup prej dy pyetjesh, një situatë në të cilën qytetarëve do t'u kërkohej të paguanin një kompensim të caktuar në para, të jepnin një dhuratë ose shërbim për të zgjidhur një problem, dhe e dyta, një situatë hipotetike ku subjekti vendoset në pozicionin e një nëpunësi të paguar dobët dhe sjelljen e tij në lidhje me paratë, dhuratën ose shërbimin e ofruar.

Vërehet një rënie e ekspozimit ndaj korrupsionit në krahasim me vitet e kaluara. Gjegjësisht, pothuajse çdo i pesti qytetar (19.0%) është i ekspozuar ndaj korrupsionit, në krahasim me 31.0% në hulumtimin e vitit 2021. Ulja e përqindjes së ekspozimit ndaj korrupsionit në vitin 2023 do të thotë se numri i atyre qytetarëve me sjellje të përziera është rritur, ndërkaq inkurajon fakti se numri (39.9%) i qytetarëve që nuk janë të ekspozuar ndaj korrupsionit po rritet.



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023


Sinjalet e përziera japin pranueshmërinë e korrupsionit nga qytetarët në vitin 2023. Në vitin 2023, 70.8% krahasuar me 59.0% të të anketuarve në vitin 2021 thanë se në rolin e nëpunësve me pagë të dobët, kurrë nuk do të pranonin një ryshfet të ofruar sepse nuk justifikojnë veprime të tilla, ndërsa 18.7% e të anketuarve në vitin 2023 krahasuar me 32.0% në vitin 2021 do të pranonin ryshfet nëse kjo nuk do të nënkuptonte shkelje të së drejtës.



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Sa i përket ekspozimit ndaj ryshfetit, 8,6% e qytetarëve thanë se do të paguanin, 11,3% do të paguanin nëse mund ta përballonin, 48,7% nuk do të paguanin në asnjë rast, ndërsa 29,8% nuk do të paguanin nëse do të kishte një mënyrë tjetër për të zgjidhur problemin.

Figure 12.
 Ekspozimi ndaj
 dhënies së
 ryshfetit
 Nëse do të kishit një
 problem të madh
 dhe ndonjë nëpunës
 do t'ju kërkonte
 drejtpërdrejt para
 për ta zgjidhur atë
 problem, çfarë do të
 bënit?



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023


Projeksioni i përqindjeve mbi popullsinë e rritur (1,461,223) të Maqedonisë së Veriut tregon se 711,615 e qytetarëve nuk janë të ekspozuar ndaj korrupsionit, por 435,444 qytetarë të tjerë, nëse nuk ka mënyrë tjetër, do të paguanin. Në këtë pikë, kjo do të thotë një burim i kufizuar i rezistencës ndaj përpjekjeve për të anashkaluar rregullat, dhe kështu një potencial i kufizuar njerëzor për të kundërshtuar kolektivisht korrupsionin. Rezultati tregon se do të duhet kohë për të arritur një masë më të madhe kritike që mund të mbushë radhët në administratë, politikë dhe biznes, të nevojshme për të luftuar me sukses korrupsionin.

1.6. Perceptimi i korrupsionit: Potenciali për parandalimin e korrupsionit

Grupi i tretë i treguesve i referohet perceptimit të korrupsionit dhe bazohet në indekset për gjasat e presionit korruptiv dhe mbizotërimit të korrupsionit. Në këtë pjesë, si treguesi i tretë për të fituar një pasqyrë të plotë të perceptimit, i dedikohet cenueshmërisë së sektorëve të ndryshëm. Në të njëjtën kohë, përmes këtij grupi treguesish, projektohen edhe perspektivat për trajtimin e mundshëm të korrupsionit në të ardhmen. Kështu, përpjekjet për parandalimin e korrupsionit mund të maten duke analizuar sjelljen korruptive të institucioneve të ndryshme shtetërore, si nga pikëpamja e perceptimit të qytetarëve ashtu edhe si burim presioni, por edhe përmes presionit të mundshëm për korrupsion dhe duke vlerësuar fizibilitetin e politikave publike për luftë kundër korrupsionit.

1.6.1. Probabiliteti për presion korruptiv


Shumica e qytetarëve besojnë se presioni për korrupsion do të vazhdojë të ekzistojë edhe në të ardhmen. Në vitin 2023, 82,0% e qytetarëve (72,7% në vitin 2021) besojnë se ekziston një probabilitet ose probabilitet i lartë i presionit të korrupsionit, në krahasim me një pjesë më të vogël prej 18,0% (27,3% në vitin 2021) të qytetarëve që besojnë se ekspozimi ndaj presionit të korrupsionit do të jetë i ulët, përkatësisht se nuk ekziston aspak. Pavarësisht uljes së presionit dhe përfshirjes aktuale, kjo është një rritje e konsiderueshme e perceptimit të ekzistencës së presionit korruptiv krahasuar me vitin 2021 dhe jep sinjale negative tek qytetarët se është e mundur përballja me korrupsionin.



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

1.6.2. Prevalenca e korrupsionit (sipas profesioneve)

Perceptimi i qytetarëve se korrupsioni është kryesisht i përhapur në mesin e nëpunësve zyrtarëve dhe në administratën publike shënon rritje në vitin 2023. Për dallim nga viti 2021, kur 69,0% e të anketuarve i konsideronin nëpunësit zyrtarë të përfshirë në korrupsion, 74,4% e ndajnë këtë mendim në vitin 2023. Në një nivel të përafërt, mendimi i të anketuarve që besojnë se të gjithë janë të përfshirë, përkatësisht nga 30,7% në vitin 2021 në 30,5% në vitin 2023, ndërsa numri i atyre që besojnë se shumica e nëpunësve zyrtarëve janë të përfshirë në korrupsion është rritur, nga 38,9% në vitin 2021 në 43,9% në vitin 2023. Vetëm 5,8% e qytetarëve mendojnë se rrallë ndodh të përfshihet ndonjë nëpunës zyrtar. Pikëpamjet janë të ndryshme midis shqiptarëve dhe maqedonasve, kështu që për dallim nga viti 2021, perceptimi i prevalencës së korrupsionit zvogëlohet midis shqiptarëve, kështu që 26,2% në vitin 2023 (43,1% në vitin 2021) të shqiptarëve besojnë se shumica e nëpunësve zyrtarëve janë të përfshirë në korrupsion, ndërsa rritet midis maqedonasve, kështu që 31,3% në vitin 2023 (26,9% në vitin 2021) të maqedonasve besojnë se shumica e nëpunësve zyrtarëve janë të përfshirë.




Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Në vitin 2023, më shumë se katër të pestat e qytetarëve besojnë se ministrat janë më të korruptuarit. Përveç kësaj, një shumicë e madhe e qytetarëve (mbi 80,0%) besojnë se deputetët, gjyqtarët dhe udhëheqësit e partive politike dhe koalicioneve janë profesionet më të korruptuara, dhe gjithashtu një shumicë (mbi 70,0%) besojnë se korrupsioni ka depërtuar edhe te doganierët, prokurorët publikë, udhëheqësit politikë lokalë, biznesmenët dhe nëpunësit tatimorë.

Mësimdhënësit dhe bankierët, ashtu si në vitin 2021, perceptohen si më pak të korruptuarit nga të gjitha 23 profesionet ose grupet e listuara, përkatësisht më pak se 25,6% përkatësisht 29,1% e qytetarëve, besojnë se janë të korruptuar. Gazetarët (43,7%) dhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile (49,3%) janë në listën ku më pak se shumica e qytetarëve e konsiderojnë veten të korruptuar.

Figura nr. 15.

Perceptimi i qytetarëve për përhapjen e korrupsionit në profesione




Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

1.6.3. Korrupsioni në institucionet shtetërore (sektorët e rrezikuar)

Perceptimi i qytetarëve thotë se korrupsioni është më i përhapur në gjykata dhe në Qeveri. Gjegjesisht, në shkallën nga një deri në pesë, ku një do të thotë nuk ka aspak korrupsion, dhe pesë do të thotë mbizotërim i korrupsionit në nivelin më të lartë, 77.6% e qytetarëve dhanë pikët më të larta (katër dhe pesë) për mbizotërimin e korrupsionit në gjykata, 75.6% për mbizotërimin e korrupsionit në Qeveri, 74.9% për mbizotërimin e korrupsionit në Kuvend, 73.2% në Prokurori dhe 70.9% besojnë se korrupsioni është mbizotërues në Dogana. Nga ana tjetër, qytetarët, ashtu si në vitet e mëparshme, kanë perceptimin më të ulët të prevalencës së korrupsionit në ushtri dhe në institucionin President.

Figura nr. 16.

Perceptimi i prevalencës së korrupsionit në institucionet shtetërore




Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Në këtë raund matës, ekziston një konvergencë midis perceptimeve të prevalencës së korrupsionit për profesionet dhe institucionet. Kështu, në këtë raund, përvoja personale e të anketuarve me profesionet me të cilat ata kanë një kontekst të shpeshtë ka ndikuar më pak në krijimin e perceptimeve të korrupsionit të profesioneve dhe duket se varet më shumë nga pamja e përgjithshme e situatës në shoqëri, e cila transmetohet përmes mediave dhe rrjeteve të njohjes së të anketuarve.

Dinamika për perceptimin në dekadën e fundit dërgon sinjale të përziera për atë që po ndodh në sferën sociale. Trendi negativ i filluar në vitin 2019 për të rritur perceptimin e korrupsionit në të gjitha sferat sociale vazhdon në vitin 2023, veçanërisht në pesë profesionet më të korruptuara, por me ulje të caktuara të tendencave në perceptimin e korrupsionit në sferat më pak të korruptuara, siç janë mësuesit, bankierët dhe gazetarët.

1.6.4. Zbatimi i politikave publike për luftën kundër korrupsionit

Sa i përket perspektivave për çrrënjosjen e korrupsionit, në vitin 2023 qytetarët tregojnë optimizëm më të madh, gjegjësisht 50.7% e qytetarëve besojnë se korrupsioni mund të zvogëlohet dhe çrrënjohet në mënyrë të konsiderueshme, por ende ekziston një përqindje e madhe e qytetarëve - 47.4% që besojnë se korrupsioni nuk mund të zvogëlohet në mënyrë të konsiderueshme. Një pesimizëm i tillë mund të përbëjë rrezik për inkurajimin e normave më të larta të pranueshmërisë dhe përfshirjes në korrupsion.



Burimi. Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Nuk vërehen dallime në pritjet kur merret parasysh prejardhja etnike e qytetarëve, kështu që 20.4% e shqiptarëve dhe 20.7% e maqedonasve besojnë se korrupsioni nuk mund të zvogëlohet. Për 26.2% të shqiptarëve dhe maqedonasve, korrupsioni do të ekzistojë gjithmonë në vend, por, megjithatë mund të zvogëlohet. Optimizëm të barabartë tregojnë 52.4% e shqiptarëve dhe 51.4% e maqedonasve që besojnë se korrupsioni mund të reduktohet ndjeshëm ose të çrrënjohet plotësisht.

Në vitin 2023, simpatizantët e BDI-së tregojnë optimizmin më të madh, kështu që për 64.0% të tyre, korrupsioni mund të zvogëlohet ose çrrënjohet ndjeshëm, krahasuar me 56.5% të simpatizantëve të VMRO-DPMNE-së dhe 54.8% të simpatizantëve të LSDM-së. Sipas 31.0% të mbështetësve të LSDM-së, në krahasim me 21.0% të VMRO-DPMNE-së dhe 16.0% të BDI-së, korrupsioni do të jetë gjithmonë i pranishëm, por megjithatë mund të zvogëlohet në një farë mase, ndërsa LSDM-ja këtë herë është më pesimiste (13.1%) në krahasim me VMRO-DPMNE-në (21.4%) dhe BDI-në (20.0%) në pritjet se korrupsioni nuk mund të zvogëlohet.


1.7. Besimi në institucionet kundër korrupsionit

Qytetarët u pyetën gjithashtu për besimin e tyre në institucionet, përkatësisht deri në çfarë mase secili prej institucioneve, sipas tyre, mund të merret me sukses me korrupsionin në Maqedoninë e Veriut.

Sipas rezultateve të anketës, në vitin 2023, besimi i qytetarëve në aftësinë për përballje me korrupsionin në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, po rritet. Në mënyrë kumulative, shumica e përgjigjeve “besim i plotë” dhe “besim i pjesshëm” ishte 33.9% për MPB-në (30.3% në vitin 2021) dhe 31.2% për KSHPK-në (24.2% në vitin 2021). Ka një rritje të konsiderueshme të mosbesimit në Qeveri ose 74.4% e qytetarëve kanë mosbesim të pjesshëm ose të plotë në Qeveri kur bëhet fjalë për përballje me korrupsionin, në kontrast me vitin 2021 kur mosbesimi u shpreh nga 66.5% e të anketuarve. Prokuroria publike (74.3% mosbesim i plotë dhe i pjesshëm) dhe gjyqësori (76.0% mosbesim i plotë dhe i pjesshëm) janë vazhdimisht në fund të listës së institucioneve në të cilat qytetarët besojnë se mund të përballen me korrupsionin.

Figura nr. 18.

Besimi në institucionet kundër korrupsionit: Sa besim keni në secilën nga institucionet e listuara më poshtë se mund të përballen me sukses me korrupsionin?



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Kur marrim parasysh përkatësinë etnike, ndryshe nga më parë, fillojnë të shfaqen dallime më serioze në besim midis maqedonasve dhe shqiptarëve, në mënyrë që maqedonasit kanë besim dukshëm më të ulët në të gjitha institucionet e listuara për sa i përket aftësisë për përballje me korrupsionin.

Nga ana tjetër, kur shohim deklaratat për sa i përket pikëpamjeve politike, vërehen dallime të mëdha në mendimet e simpatizantëve të tre partive më të mëdha, gjë që sigurisht është e pritshme.

Mbështetësit e BDI-së kanë pritshmëri pozitive nga të gjitha institucionet, ndërsa mbështetësit e LSDM-së besojnë në to dukshëm më shumë. Përkundrazi, mbështetësit e VMRO-DPMNE-së treguan mosbesim shumë të madh ndaj institucioneve, përkatësisht më shumë se 80.0% e tyre thanë se nuk besojnë në pothuajse të gjitha institucionet përgjegjëse për luftimin e korrupsionit (veçanërisht në Qeverinë në të cilën 91.9% e mbështetësve të VMRO-DPMNE-së, nuk besojnë). Nga ana tjetër, mosbesimi më i vogël, por ende shumë i lartë, u shpreh në lidhje me aftësinë e KSHPK-së. Ajo që është interesante të theksohet është se, megjithatë, besimi i simpatizantëve bie ndjeshëm kur bëhet fjalë për prokurorinë publike dhe gjyqësorin.

Tabela nr. 5.

Besimi në institucionet kundër korrupsionit: Sa besim keni në secilën nga institucionet e listuara më poshtë se mund të përballen me sukses me korrupsionin?

Institucioni	VMRO-DPMNE			LSDM		
	2019	2021	2023	2019	2021	2023
Qeveria	18.8	9.1	7.4	62.8	72.4	67.9
Ministria e Punëve të Brendshme	22.4	12.1	19.2	62.2	62.2	76.2
KSHPK	14.1	7.3	24.0	37.9	51.0	58.3
Prokuroria Publike	12.2	6.5	12.9	41.8	51.8	40.5
Gjykatat	7.7	7.9	14.0	35.1	45.2	84.9

Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

2.

Politikat kundër
korrupsionit dhe
kuadri ligjor



2.1. Strategjitë ekzistuese kundër korrupsionit, planet dhe programet e veprimit

Dokumenti kryesor për politikat kundër korrupsionit është **“Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave (2021–2025)”**⁴ e⁴ përgatitur nga KSHPK dhe e miratuar nga Kuvendi në prill 2021⁵. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare duhet të kontribuojë në uljen e nivelit të korrupsionit, përmirësimin e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në të gjithë sektorët e shoqërisë, duke siguruar kështu që publiku të ketë besim më të lartë në punën e pushtetit legjislativ, gjyqësor dhe ekzekutiv. Përgatitja e strategjisë u zhvillua në një proces të gjerë konsultimi. Strategjia është ndër-sektoriale dhe identifikon rreziqet e korrupsionit në disa fusha të sistemit. Për herë të parë, ndërmarrjet shtetërore, planifikimi hapësinor dhe urban, sporti, bujqësia dhe mjedisi jetësor janë identifikuar si fusha rreziku në strategji.

KSHPK-ja është bartëse e procesit të hartimit të Strategjisë dhe monitoron zbatimin e saj, ndërsa të gjitha subjektet nga sektori publik, privat dhe civil luajnë një rol aktiv në zbatimin e saj. KSHPK-ja i dorëzon Kuvendit raporte vjetore për punën e saj dhe raporte për zbatimin e strategjisë kombëtare (në përputhje me nenet 18.6, 18.7 dhe 19.2 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit).

Sipas raportit vjetor të KSHPK-së për vitin 2022 për zbatimin e Strategjisë Kombëtare, në vitin 2022, 10% e aktiviteteve u zbatuan plotësisht, 35% ishin në vazhdim dhe 55% nuk u zbatuan⁶. Sipas raportit vjetor për vitin 2021, 20% e aktiviteteve u zbatuan plotësisht, 27% ishin në vazhdim, dhe 59% nuk u zbatuan fare. Sipas shërbimeve të Komisionit Evropian, për të qenë efektiv, zbatimi i strategjisë duhet të bëhet në të gjitha nivelet e administratës. Institucionet përgjegjëse duhet të ndërtojnë një sistem efektiv të raportimit mbi shkallën e zbatimit të aktiviteteve. Shkalla e ulët e zbatimit të strategjisë kombëtare tregon mungesë të angazhimit politik dhe ndjenjës së pronësisë midis institucioneve⁷.

Si rezultat i zbatimit të pamjaftueshëm të strategjisë, KSHPK vendosi të ndërmarrë hapa për ta ndryshuar atë. Në këtë drejtim, u mbajtën një sërë punëtori në mjediset e KSHPK-së, me mbështetjen e Fondacionit Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore IFES. Në këto punëtori u shqyrtua propozim - materiali për ndryshimin e Strategjisë Kombëtare 2021–2025, si dhe propozimet e reja të bëra nga pjesëmarrësit⁸ në secilin prej seminareve sipas sektorëve individualë të strategjisë.

4 Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2021–2025 (<https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/01/Nacionalna-strategjia-DKSK-KONECNA.pdf>)

5 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 86/2021

6 Nga 165 aktivitete të planifikuara për vitin 2022, 17 janë zbatuar, 90 nuk janë zbatuar, ndërsa 58 aktivitete janë në zbatim.

7 Skrinin raporti, Maqedonia e Veriut, Cluster 1 - Bazat

8 Në punëtoritë marrin pjesë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, ekspertë, institucione që përcaktohen si institucione kompetente ose të përfshira për zbatimin e një aktiviteti të caktuar, përkatësisht persona të punësuar në njësitë organizative që marrin pjesë drejtpërdrejt në zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në SK 2021–2025, si dhe persona që institucionet besojnë se mund të kontribuojnë në ndryshimin e Strategjisë Kombëtare.

Maqedonia e Veriut është nënshkruese e të gjitha dokumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale kundër korrupsionit, duke marrë kështu detyrime për të vepruar në këtë fushë, ndërsa në të njëjtën kohë ofron mundësi për të marrë mbështetje nga bashkësia ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit.

Në fushën e prokurimeve publike, vendi ka miratuar **Strategjinë për përmirësimin e sistemit të prokurimeve publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV) (2022-2026)**, me plane vjetore të veprimit. Byroja për Prokurime Publike monitoron zbatimin e strategjisë. Strategjia është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit. Strategjia përcakton masat për të luftuar korrupsionin dhe konfliktin e interesit.

Nën përgjegjësinë e Kabinetit të Zëvendëskryeministrit të Republikës së Maqedonisë së Veriut përgjegjës për politikën për qeverisje të mirë, po përgatitet dhe zbatohet **Plani i Politikave për Qeverisje të Mirë**. Deri më tani, janë miratuar plane për⁹ vitin 2022 dhe¹⁰ 2023 që ofrojnë një pasqyrë të prioriteteve kombëtare në fushën e qeverisjes së mirë. Planet dhe objektivat e përcaktuara janë në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe planin e saj të veprimit.

Nën përgjegjësinë e Zëvendëskryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut përgjegjës për politikën për qeverisje të mirë, përgatitet, **Strategjia e re për Transparencë të Qeverisë, me një plan veprimi (2023-2026)**. Për përgatitjen e strategjisë, formohet një grup pune me përfaqësues nga institucionet shtetërore, sektori civil, përfaqësues nga shoqatat e gazetarëve dhe organizatat ndërkombëtare me bazë në vend. Strategjia do të shërbejë si një mekanizëm për lidhjen dhe harmonizimin e të gjitha dokumenteve dhe ligjeve strategjike dhe akteve nëligjore të miratuara deri më tani, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë synojnë të përmirësojnë transparencën e institucioneve qeveritare, duke mundësuar kështu një nivel më të lartë të llogaridhënies së nëpunësve publikë dhe funksionarëve ndaj qytetarëve¹¹.

2.2. Ligji i specializuar kundër korrupsionit

Në vitin 2019, u miratua **Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave**, i¹² cili kombinoi korrupsionin dhe konfliktin e interesit. Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, rregullon masat dhe aktivitetet për parandalimin e korrupsionit në ushtrimin e pushtetit, kompetencave publike, detyrës dhe politikës zyrtare, masat dhe aktivitetet për parandalimin e konfliktit të interesit, masat dhe aktivitetet për parandalimin e korrupsionit në kryerjen e aktiviteteve me interes publik të subjekteve juridike që lidhen me ushtrimin e kompetencave publike. Lidhur me parandalimin e konfliktit të interesave, ligji përcakton qartë procedimin dhe raportimin, si dhe procedurën para KSHPK-së në rast të konfliktit të interesave.

9 ggpp2022_fina_mk.pdf (vlada.mk)

10 plan_2023_public_fina_mk_0_0.pdf (vlada.mk)

11 Ka filluar procesi i përgatitjes së Strategjisë për Transparencë të Qeverisë me plan veprimi (2023-2026) | Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (vlada.mk)

12 Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 12/2019)

Në rast dyshimi për konflikt interesi, KSHPK-ja zhvillon procedurën për përcaktim. Për të arritur transparencë më të madhe dhe llogaridhënie institucionale, KSHPK-ja informon publikun për këto raste të konfliktit të interesit.

Ligji gjithashtu përmban masa për parandalimin e korrupsionit në politikë, përfshirë financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore, kryerjen e kompetencave publike, çështje me interes publik dhe aktivitete të tjera të kryera nga subjektet juridike. Ligji gjithashtu autorizon KSHPK-në, të hetojë privilegjet ose diskriminimin në kontratat e prokurimit publik ose të kërkojë nga institucionet kompetente të marrin masa dhe aktivitete të caktuara. Ligji ndalon ushtrimin e ndikimit në procedurat e prokurimit publik.

Ligji i vitit 2019 përcaktoi kritere serioze për përzgjedhjen e përbërjes profesionale të KSHPK-së dhe një procedurë transparente dhe gjithëpërfshirëse për zgjedhjen e anëtarëve, që i parashikon pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave, dhe nuk përfshin përfaqësues të Qeverisë.

2.3. Legjislacioni kundër korrupsionit

Raundi i pestë i vlerësimit të GRECO-s i referohet “Parandalimit të korrupsionit, promovimit të integritetit të pushteti qendror (personat e ngarkuar me funksionet më të larta ekzekutive - PFLE) dhe organet e zbatimit të ligjit (OZL)”. GRECO bëri 23 rekomandime për Maqedoninë e Veriut në raportin e saj të vlerësimit. Nga 23 rekomandime, 4 janë zbatuar në mënyrë të kënaqshme, 9 kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe 10 nuk janë zbatuar.¹³

Në bazë të **Ligjit për kundërvajtje** të vitit 2019¹⁴, procedura e kundërvajtjes është thjeshtuar - opsioni për prolongimin e parashtrimit të ankesës deri te Komisioni (i shkallës së dytë) për procedurat e kundërvajtjes është shfuqizuar, ndërsa kryerësi për të cilin është vendosur gjobë tani mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore drejtpërdrejt në Gjykatën Administrative. Në drejtim të zbatimit praktik të sistemit të sanksioneve në drejtim të shkeljes së rregullave/legjislacionit për konfliktin e interesit, integritetit dhe anti-korrupsionit dhe sigurisë, theksohet se sanksionet janë efektive, proporcionale dhe parandaluese. Këtë e tregojnë statistikat e KSHPK-së, që është një tregues i numrit të madh të sanksioneve të vendosura për shkelje nga ushtruesit e funksioneve publike, përfshirë personat që kryejnë funksionet më të larta ekzekutive.

Ndryshimet e shpeshta dhe plotësimet në **Ligjin për punë të brendshme** do të synojnë të nënshtrojnë personelin e policisë në kontrolle të rregullta të integritetit profesional. Në këtë kontekst, neni 64-6 “Test për integritetin profesional” ka një rëndësi të veçantë, i cili përqendrohet në parandalimin e korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, me qëllim forcimin e integritetit të punëtorëve në ministri dhe veprimin parandalues, ndërsa njësia organizative e përmendur në nenin 58 të këtij ligji kryen kontrolle të integritetit duke kryer test të integritetit profesional të punëtorëve në ministri¹⁵.

13 <https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Izvestaj/Greko/petti-krug.pdf>

14 Ligji për kundërvajtje (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 96/2019)

15 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për punë të brendshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 89/2022)

Kodi penal¹⁶ gjithashtu është ndryshuar dhe plotësuar në vitet e fundit, dy herë në vitin 2015 dhe në vitin 2017, si dhe një herë në vitin 2018 dhe në vitin 2023. Ndryshimet në këtë ligj janë një plotësim i ndryshimeve në vitet e mëparshme, në lidhje me rekomandimet e GRECO-s nga të 5 rundet e vlerësimit, si dhe harmonizimin e mëtejshëm me standardet ndërkombëtare.

Ndryshimet e fundit në kodin penal të vitit 2023 u miratuan në një procedurë të shkurtuar me flamur evropian. Ndryshimet u pritën me revoltë të madhe nga sektori publik dhe civil. Ndryshimet ulën dënimet e përmendura në nenin 353 të Kodit penal në lidhje me shpërdorimin e detyrës dhe autorizimit, si dhe shfuqizuan dispozitën për sanksionimin e shpërdorimit të detyrës dhe autorizimeve gjatë kryerjes së prokurimit publik ose në dëm të buxhetit dhe mjeteve publike, si dhe ulën dënimet për veprën penale për shoqërim kriminal të përmendur në nenin 394. Me zvogëlimin e lartësisë së dënimeve për vepra të veçanta është zvogëluar edhe kohëzgjatja e parashkrimit të tyre, si dhe me ndryshimet është shfuqizuar konfiskimi i zgjeruar i pronës së fituar në mënyrë të paligjshme¹⁷.

Plotësimet dhe ndryshimet e **Kodit penal**¹⁸ gjithashtu, hynë në fuqi, vitet e fundit. Ndryshimet në Kodin zgjedhor parashikojnë kontroll dhe rregullim më të madh të transmetimit të reklamave politike me pagesë, për sa i përket kohëzgjatjes, afateve kohore, etiketimit transparent për financimin e reklamave, dhe të gjitha këto dhe rregullore të ngjashme rregullohen nga neni 75-d, paragrafët 1 dhe 2 të Kodit zgjedhor¹⁹. Ligji gjithashtu rregullon ndalimin e transmetimit të reklamave politike me pagesë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në fillim të fushatës zgjedhore. Një numër ndryshimesh kishin për qëllim edhe përfaqësimin mediatik të partive në kuadër të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (AShMAA). Kështu, AShMAA është e detyruar të paraqesë një raport mbi reklamimin politik të paguar të radiodifuzerëve në Komisionin Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) në ditën e dhjetë të fushatës zgjedhore dhe në ditën e shtatë pas përfundimit të fushatës zgjedhore. Këto ligje synojnë të mundësojnë konkurrencë të barabartë dhe transparencë në financimin e fushatave politike dhe uljen e korrupsionit në proceset zgjedhore.

Kuadri ligjor për financimin e partive politike përbëhet nga dy ligje, përkatësisht Ligji për financimin e partive politike²⁰ dhe Ligji për qendrat hulumtuese dhe analitike të partive²¹. Enti Shtetëror për Revizion (EShR) mbikëqyr operacionet financiare të partive politike dhe bën revizion të fushatave zgjedhore. Përgjegjësitë e KSHPK-së përcaktohen në Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Ato përbëhen kryesisht nga monitorimi, zbulimi dhe marrja e masave ndaj personave përgjegjës në organet dhe institucionet shtetërore. Veprimi mund të ndërmerret nëse ekziston dyshimi se mjetet buxhetore/ komunale përdoren për të organizuar ose financuar fushatën zgjedhore, nëse ekziston dyshimi se fushata zgjedhore financohet nga burime që nuk përputhen me dispozitat ligjore ose vijnë nga burime anonime, dhe nëse partitë politike financohen nga burime të paautorizuara ose të paligjshme.

16 Kodi penal ("Gazeta Zyrtare e Maqedonisë" nr. 37/1996)

17 Gazeta Zyrtare 188/2023

18 Kodi penal (Gazeta Zyrtare e Maqedonisë nr. 40/2006)

19 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 140/2018)

20 Gazeta Zyrtare 74/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13 dhe 140/18 dhe Gazeta Zyrtare 294/20

21 Gazeta Zyrtare 23/13 dhe 15/2015

Sipas vlerësimit të Komisionit Evropian, kuadri ligjor për financimin e fushatave zgjedhore përmban mjaft lëshime. Për të rritur transparencën, Kodi zgjedhor duhet të kërkojë zbulimin gjithëpërfshirës të të gjitha llojeve të të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës nga konkurrentët. Sipas Komisionit Evropian, përpjekjet duhet të vazhdojnë për të përmirësuar efikasitetin e sistemit demokratik, duke përfshirë transparencën për financimin e partive politike. Në këtë drejtim, rekomandimet e GRECO-s për "Transparencën e financimit të partive" duhet të përkthehen në masa përkatëse²².

Reformimi i procesit zgjedhor konsiderohet si prioritet, përfshirë miratimin e një kodi të ri zgjedhor. Në maj 2023 u krijua një grup pune për ndryshimin e Kodit zgjedhor, i cili përfshin përfaqësues të partive politike, organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë.

Ligji për regjistrin qendror është ndryshuar ndër vite me qëllim minimizimin e pengesave administrative të shoqërive, nëpërmjet digjitalizimit të proceseve, gjë që zvogëlon kontaktin midis klientëve, duke ulur kështu rrezikun e korrupsionit dhe ryshfetit. Por nuk digjitalizohet vetëm regjistri qendror, por edhe lidhja mes regjistrit qendror dhe organeve të tjera shtetërore të prekura.

2.4. Kuadri legjislativ për luftën kundër korrupsionit në gjyqësor

Për të pasur një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, **Ligji për gjykatat** plotësohet, për shembull, në vitin 2018. Ligji për gjykatat²³ është plotësuar, kështu që ai parashikon rregullativa më të vështira disiplinore që iniciohen në procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit, si bazë për shkarkim konsiderohen gjithashtu: anëtarësimi në një parti politike, përfitimi nga funksioni dhe reputacioni i gjykatës për të ushtruar interesa private, arritja e një vlerësimi të pakënaqshëm në dy vlerësime të rregullta të mëvonshme nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, që konsiderohet të jetë joprofesional dhe e ushtron funksionin gjyqësor në mënyrë të paligjshme, kryer funksion tjetër publik, punë ose veprimtari që nuk përputhen me kryerjen e funksionit gjyqësor, pranon dhurata dhe përfitime të tjera në lidhje me punën gjyqësore, vendos të mos zbatojë pikëpamjet e shprehura në aktgjykimet përfundimtare të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të paraqet (zbulon) informacione konfidenciale të cilat i ka kuptuar duke vepruar në lidhje me lëndë ose duke ushtruar funksionin gjyqësor. Gjithashtu, në vitin 2019, në të njëjtin ligj u shtuan dhe paraqitën kushte të veçanta plotësuese për zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatën themelore, gjykatën e apelit dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Këto dhe rregullore të tjera ligjore që janë plotësuar ndër vite zgjerojnë fushën e kufizimeve për gjyqtarët, punën e tyre, veprimtarinë jashtë punës, si dhe procesin e zgjedhjes së tyre, duke kufizuar kështu mundësinë e korrupsionit në sistemin gjyqësor.

22 Draft Raporti i shqyrtimit, Maqedonia e Veriut, Cluster 1 – Bazat, 20/07/2023

23 Ligji për plotësimin e Ligjit për gjykatat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. (83/2019)

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe efikasitetit, hyri në fuqi **Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë**²⁴. Kështu, me ligj, seancat e Këshillit janë publike, përveçse me vendim të Këshillit (me shumicë se dy të tretat), me qëllim mbrojtjen e prokurorit publik, përveç rasteve kur zgjidhet një prokuror publik, publiku në asnjë rast nuk mund të përjashtohet. Ligji parashikon edhe përjashtimin e një anëtari të Këshillit, nëse gjatë ushtrimit të funksionit të tij mëson për ekzistencën e rrethanave që mund të shkaktojnë dyshime për paanshmërinë e tij dhe është i detyruar të njoftojë menjëherë Këshillin, i cili do të marrë një vendim të përshtatshëm. Këshilli i Prokurorëve Publikë, brenda shtatë ditëve nga dita e votimit për zgjedhjen e Prokurorit Themelor Publik të Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, emëron si Prokuror Themelor Publik të Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit kandidatin që ka fituar më shumë vota në votim nga të gjithë prokurorët publikë në Maqedoninë e Veriut. Këto ndryshime janë të një rëndësie të madhe në luftën kundër korrupsionit, si dhe në sigurimin e transparencës, paanshmërisë, pavarësisë dhe llogaridhënies së Këshillit, prokurorëve publikë dhe sistemit të plotë gjyqësor.

Një grup pune i udhëhequr nga Nënkryetari i Qeverisë përgjegjës për politikën e qeverisjes së mirë përgatiti një **propozim - ligj për konfiskimin e pasurisë në procedurat civile**, i cili do t'i paraqitet BE-së dhe Komisionit të Venecias për mendim, dhe më pas do të diskutohet në një dëgjim publik para publikut të gjerë, me qëllim miratimin e një ligji funksional dhe të zbatueshëm në përputhje me standardet ndërkombëtare. Sipas Qeverisë, ligji do të mundësojë krijimin e një mekanizmi plotësues për të parandaluar me sukses pasurimin e padrejtë dhe konfiskimin e pasurisë që nuk është fituar nga burimet ligjore. Një ligj i tillë është i nevojshëm për të forcuar luftën kundër korrupsionit në vend²⁵. Duke marrë parasysh afatin kohor dhe dinamikën e punës së grupit të punës për këtë ligj, Platforma e Organizatave të Shoqërisë Civile për Luftën kundër Korrupsionit u tërhoq nga grupi i punës, duke vlerësuar se dobësitë e gjetura në tekstin e propozuar nuk mund të hiqen në mënyrë thelbësore. Përveç mangësive në procesin e konsultimit, Platforma vlerëson se ka mungesë të analizës adekuate të situatës dhe justifikimit të një zgjidhjeje të tillë ligjore dhe se një analizë e tillë do të tregojë se tashmë ekzistojnë mekanizma për konfiskimin e pasurisë në kuadrin ligjor të shtetit, të cilat nuk zbatohen në mënyrë adekuate²⁶.

24 Ligji për ndryshimin e Ligjit për Këshillin e prokurorëve publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 42/2020)

25 Grkovska: Do të ketë debat të gjerë publik për Ligjin për konfiskimin e pronës në procedurë civile pas marrjes së mendimeve nga BE-ja dhe Komisioni i Venecias | Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (vlada.mk)

26 [Korrespondenca e Platformës] Tërheqja nga Grupi Punues për Krijimin e Ligjit për Konfiskimin e pronës në procedurën civile – Antikorupsion | Platforma Kundër Korrupsionit (antikorupcija.mk)

2.5. Instrumentet e tjera ligjore për luftë kundër korrupsionit

Në vitet e fundit, disa ligje janë ndryshuar dhe ligjet e reja kundër korrupsionit kanë hyrë në fuqi. Një nga ato ligje është **Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve**²⁷, i cili rregullon raportimin e mbrojtur, të drejtat e sinjalizuesve, si dhe veprimet dhe detyrat e institucioneve, përkatësisht personave juridikë në lidhje me raportimin e mbrojtur dhe sigurimin e mbrojtjes së sinjalizuesve. Në këtë drejtim, është përgatitur një doracak për mbrojtjen e sinjalizuesve në²⁸ kuadër të IPA tuining projektit “Mbështetje për parandalimin efektiv dhe luftën kundër korrupsionit”, financuar nga BE, dhe zbatuar nga KSHPK. Mbikëqyrja mbi zbatimin e ligjit bëhet nga Ministria e Drejtësisë. KSHPK mbledh të dhëna, përgatit raporte, i dorëzon ato në Kuvend dhe ato janë në dispozicion të publikut.

Që në vitin 2008, ekzistonte **Ligji për lobim**, por raporti i katërt i GRECO-s për Maqedoninë e Veriut²⁹ identifikoi dobësi serioze në lidhje me strukturën ekzistuese të lobimit. Duke marrë parasysh situatën aktuale, rekomandimet e siguruara dhe me qëllim harmonizimi me standardet ndërkombëtare për lobim, u propozua miratimi i ligjit të ri për lobim. Kështu, ligji origjinal i vitit 2008 u bë i pavlefshëm dhe në vitin 2021 u miratua Ligji i ri për lobimin, i³⁰ cili hyri në fuqi në vitin 2022, ndërsa të gjitha aktet nënligjore të lidhura u miratuan nga KSHPK-ja në dhjetor 2021. Ligji zgjeroi kompetencat e KSHPK-së, duke shtuar kompetencën për të drejtuar dhe regjistruar lobistët dhe organizatat.

Ligji për prokurimet publike³¹, së bashku me aktet nënligjore, siguron një kuadër ligjor solid për krijimin e një sistemi modern, transparent dhe efikas të prokurimit publik. Ligji është kryesisht në përputhje me Direktivat e BE-së që rregullojnë fushën e prokurimit publik dhe vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Ligji aktual lejon autoritetet kontraktore të zbatojnë prokurimin publik në mënyrë transparente, efikase dhe strategjike. Në vitin 2019, u miratua **Ligji për Prokurimin Publik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë**³², duke plotësuar kështu kuadrin ligjor dhe në të njëjtën kohë duke transferuar ligjin e BE-së për prokurimin publik në legjislationin tonë kombëtar për prokurimin publik. Ky ligj siguron transparencë, konkurrencë të lirë e të ndershme dhe shpenzim racional të mjeteve publike në zbatimin e prokurimit. Kështu, procesi i dhënies së kontratave të prokurimit publik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, përkatësisht planifikimi, zbatimi i proceseve, përfundimi dhe zbatimi i kontratave është një proces transparent ekonomik dhe efikas. Prandaj, në vitin 2021, ky ligj u ndryshua për të³³ siguruar ekonominë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë rezultoi me akte nënligjore. Kështu, Ministria e Mbrojtjes miratoi një rregullore për formën dhe përmbajtjen e regjistrave të operatorëve ekonomikë, një

27 Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 196/2015).

28 Doracak për mbrojtjen e sinjalizuesve (KSHKP)

29 [https://www.pravda.gov.mk/upload/Documents/GrecoRC4\(2016\)8-Republic-of-Macedonia-MK.pdf](https://www.pravda.gov.mk/upload/Documents/GrecoRC4(2016)8-Republic-of-Macedonia-MK.pdf)

30 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lobim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 122 / 2021)

31 Ligji për prokurime publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, b4. 24/19)

32 Ligji për prokurimin publik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.180/2019)

33 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 176/21)

mënyrë për mbajtjen e regjistrave, si dhe disponueshmërinë e informacionit mbi prokurimet aktuale. Për më tepër, u miratua një rregullore për mënyrën e kontrollit dhe konfirmimit të përshtatshmërisë së kushteve në procedurat e prokurimit.

Ligji për investimet strategjike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i miratuar në janar 2020, i cili parashikon një përjashtim nga zbatimi i Ligjit për prokurimin publik, në nenin 4 përcakton projektet e investimeve strategjike dhe projektet që “zbatohen në bazë të marrëveshjeve midis vendeve” dhe konsiderohen projekte strategjike. Sipas informacioneve të dhëna nga institucionet kompetente, status të projekteve investuese strategjike kanë marrë 10 projekte me një vlerë totale prej 1.7 miliardë euro (nga 24 kërkesa të pranuar), pas miratimit të ligjit. Tetë nga këto projekte me një vlerë totale prej 1.3 miliardë euro janë në sektorin e energjisë. Gjithashtu, nuk është dhënë asnjë informacion në lidhje me procedurat e prokurimit të përdorura për zbatimin e këtyre projekteve. **Ligji për Përcaktimin e Interesit Publik dhe Emërimin e një Partneri Strategjik për Zbatimin e Projektit të Ndërtimit të Korridorit VIII dhe Pjesës së Korridorit X** të korrikut 2021 përcakton në nenin 4 të tij se dispozitat e Ligjit për prokurimin publik nuk do të zbatohen për dhënien e kontratave në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e projektit.

Sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian, vendi duhet të sigurojë transparencë dhe pajtueshmëri me ligjin e BE-së për prokurimin publik në zbatimin e Ligjit për investimet strategjike, si dhe në zbatimin e marrëveshjeve ndërqeveritare.

Lidhur me koncesionet, **Ligji për koncesione dhe partneritetin publik-privat 2012** (Ligji për koncesionet dhe partneritetin publik-privat) dhe shtatë aktet nënligjore të tij nuk janë plotësisht në përputhje me Direktivën për Koncesionet të BE-së 2014, të cilës i parapriu, por respekton parimet e përgjithshme të BE-së. Mungojnë përkufizime dhe përcaktime të qarta në lidhje me rregullat dhe procedurën për dhënien e një partneriteti publik-privat, siç është një kontratë publike për punë ose shërbime ose një koncesion. Sipas rekomandimeve në raportin e Komisionit Evropian, vendi duhet të miratojë një ligj për partneritetin publik-privat dhe një ligj për koncesionet, në mënyrë që të harmonizojë kuadrin ligjor me legjislacionin e BE-së.

Byroja për Prokurime Publike (BPP) ka zhvilluar një sistem të sofistikuar elektronik për prokurimin publik³⁴ që është i vetmi sistem kompjuterik i disponueshëm në internet, përmes të cilit mundësohet plotësimi dhe publikimi i njoftimeve për dhënien e kontratave të prokurimit publik, njoftimeve të kërkesave për mbledhjen e ofertave, njoftimeve të kontratave të lidhura, procesverbaleve të kërkesave për mbledhjen e ofertave, anulimin e procedurave, zbatimin e procedurave për dhënien e kontratave për prokurim publik me mjete elektronike (duke përdorur pajisje elektronike për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave), si dhe kryerjen e ankandëve elektronike. Është në rrjedhë zhvillimi i një platforme për e- treg, e-katalogje, përkatësisht përmirësimi i mëtejshëm i sistemit për përpunim. Vazhdoi praktika e regjistrimit të kompanive “në listën e zeze” për shkak të keqpërdorimit profesional në fazën e prokurimit, e cila nuk është në përputhje me rregullat e BE-së. Në vitin 2021 janë nxjerrë 33 rekomandime negative nga autoritetet kontraktore, gjashtë prej të cilave janë refuzuar nga BPP.

34 <https://www.e-nabavki.gov.mk>

2.6. Rasti “Korridore”

Në korrik 2021 Kuvendi miratoi ligjin për caktimin e partnerit strategjik për ndërtimin e korridorit 8 dhe të një pjese të korridorit 10³⁵. Ky ligj e përjashtoi projektin nga zbatimi i Ligjit për prokurimin publik dhe e dha kontratën drejtpërdrejt pa procedurë konkurruese. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit filloi procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së këtij ligji²². KSHPK thekson se ligji në tërësi është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nga aspekti i dispozitave të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe se është një faktor me rrezik të lartë për korrupsion dhe konflikt interesi. Në dhjetor 2021, Gjykata Kushtetuese e refuzoi këtë kërkesë. Më tej theksohet se, siç thuhet në vetë ligjin, suspendimi ose përjashtimi i ligjeve të tjera përbën një kërcënim serioz për sundimin e ligjit. Pezullimi ose përjashtimi i ligjeve të tjera lejon hapësirë për korrupsion, mundësinë e shpërdorimit të detyrës, autoritetit publik dhe detyrës zyrtare. KSHPK përveç fillimit të procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për përcaktimin e interesit publik dhe emërimit të partnerit strategjik për zbatimin e projektit për ndërtimin e korridorit të infrastrukturës 8 dhe korridorit 10, kërkon që ky ligj të anulohet, por edhe të ndalojë ekzekutimin e akteve ose veprimeve individuale të miratuara/të ndërmarra në bazë të ligjit të kontestuar. Disa organizata të shoqërisë civile gjithashtu reagues ndaj ligjit të kontestuar, ndërsa një prej tyre është Platforma e Organizatave të Shoqërisë Civile për Luftën kundër Korrupsionit, e cila paraqiti kërkesë³⁶ për tërheqjen e rendit të ditës të seancës së 112-të të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kërkesa u bë sepse Platforma vlerëson se i gjithë procesi përfshin rreziqe korrupsioni duke anashkaluar ligjet e përgjithshme. Pavarësisht të gjitha këtyre reagimeve, Gjykata Kushtetuese vendosi mosfillimin e procedimit dhe mosvlerësimin e ligjit të kontestuar dhe gjyqtarët nuk dhanë asnjë shpjegim për një vendim të tillë.

Informacioni kryesor mbi marrëveshjet për korridoret u publikua më 12 prill 2023³⁷, kur qeveria njoftoi se konsorciumi amerikano-turk Bechtel dhe Enka duhet të përfundojë ndërtimin e akseve të autostradave të korridoreve 8 dhe 10-D në një gjatësi totale prej 110 kilometrash në 57 muaj, ose në vitin 2027. Qeveria e nënshkroi marrëveshjen më 8 mars të këtij viti, kur u paraqit se ndërtimi do të kushtonte rreth 1.3 miliardë euro. Nuk ishte e qartë nëse çmimi dhe afati i shpallur (1.3 miliardë euro dhe 57 muaj) presupozon ligjet aktuale ose ligje që ende nuk janë ndryshuar. Këto paqartësi morën përgjigje se afati dhe çmimi supozohet të jenë me ligjet e ndryshuara. Kjo, në praktikë, do të thotë se Qeveria negocioi dhe bëri një marrëveshje të bazuar në norma ligjore joekzistuese në atë kohë.

Për të kaluar më shpejt ligjet e nevojshme, qeveria u mbështet në flamurin evropian. Sa i përket miratimit të ligjeve me flamur evropian, zëvendëskryeministri Artan Grubi tha se ndryshimet në ligje janë në interes të qytetarëve sepse vetëm në këtë mënyrë procesi do të jetë më i shpejtë, më i mirë dhe më i lirë. Për më tepër, zëvendëskryeministri thekson se BE-ja ka renditur korridoret 8 dhe 10 në korridoret gjeostrategjike, duke justifikuar kështu përdorimin e

35 Ligji për Përcaktimin e Interesit Publik dhe Emërimin e Partnerit Strategjik për Zbatimin e Projektit për Ndërtimin e Korridorit të Infrastrukturës 8 (seksioni: Projekti i Autostradës Tetovë-Gostivar-Bukojçani dhe Projekti i Autostradës Trebenishta-Strugë-Kafasan) dhe Korridori 10e (seksioni i Autostradës Prilep-Manastir) në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 163/2021)

36 <https://www.antikorupcija.mk>

37 <https://360stepeni.mk/vladata-napravila-dogovor-so-behtel-i-enka-vrz-osnova-i-na-nepostoechki-zakonski-odredbi/>

flamurit evropian. Me deklarimin se ndërtimi do të kishte qenë më i lirë, ka mospërputhje për shkak të faktit se çmimi nuk dihet fare, dhe sa do të jetë çmimi nëse nuk përfundon brenda afatit të caktuar.³⁸ Lidhur me përdorimin e flamurit evropian, njoftoi edhe ambasadori evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut, David Gere, i cili kontestoi përdorimin e flamurit evropian në ligjet në lidhje me korridoret 8 dhe 10, sepse ky ligj nuk sjell ndonjë harmonizim me standardet e BE-së.³⁹

Me ndryshimet në ligje, qeveria synon të sigurojë që punëtorët që do të angazhohen në ndërtimin e korridoreve të punojnë më shumë se 40 orë në javë. Një përpjekje e tillë u bë nga Qeveria përmes Ligjit për Ndërtimin e akseve të Korridoreve 8 dhe 10, i cili parashikonte orar pune prej 60 orësh në javë. Ndryshimet në ligjet e tjera parashikojnë gjithashtu një sërë përjashtimesh nga detyrimet, të tilla si përjashtimi nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe akciza mbi energjinë, por edhe përjashtimi nga TVSH-ja, detyrimet e importit dhe tatimin mbi automjetet motorike (për automjetet për terren) të partnerit strategjik. Gjithashtu parashikohet përsheptimi i procedurës së shpronësimit. Kështu, për shembull, vendimi për shpronësim nuk do të jetë i vlefshëm, por do të jetë i mjaftueshëm që ai të bëhet vetëm përfundimtar.

2.7. Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit dhe parandalimi i korrupsionit në institucione

Në Maqedoninë e Veriut, janë aplikuar dy modele aktuale për vlerësimin e rrezikut të korrupsionit. Ky është modeli i vlerësimit të rrezikut të korrupsionit institucional bazuar në vetëvlerësim, i cili është në fuqi që nga viti 2009 në përputhje me Ligjin për kontrollin e brendshëm financiar publik⁴⁰ dhe menaxhohet nga Ministria e Financave, dhe metodologjia është përgatitur me ndihmë ndërkombëtare. Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave përcakton rreziqet e korrupsionit si çdo lloj dobësie ose procesi të brendshëm ose të jashtëm që mund të paraqesë mundësinë e korrupsionit në organet shtetërore, ndërmarrjet publike dhe institucionet e tjera të sektorit publik. Bazuar në rreziqet e përcaktuara të listuara, kryhet procesi i identifikimit të rreziqeve të korrupsionit dhe përmban hapat e mëposhtëm: mbledhjen dhe analizimin e informacionit që është i rëndësishëm për institucionin (rishikim i jashtëm dhe i brendshëm), identifikimin e fushave, proceseve/funksioneve dhe treguesve për të identifikuar të gjitha rreziqet përkatëse, identifikimin e treguesve, rreziqet e korrupsionit dhe dobësitë e korrupsionit.

Modeli i dytë është një vlerësim sektorial institucional i rrezikut bazuar në një vlerësim të jashtëm – në vitin 2019, u bënë disa vlerësime sektoriale me mbështetjen e një donatori ndërkombëtar, që synonte të ndihmonte në përpjekjet e planifikimit strategjik. Në bazë të kompetencave të KSHPK-së, dhe në veçanti nenit 17, pika 17 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, KSHPK-ja përgatit analiza mbi rrezikun e korrupsionit në sektorë të ndryshëm.

38 <https://360stepeni.mk/grubi-im-se-izvini-na-mediumite-zashto-vladata-nedovolno-jasno-im-go-prezentirala-dogovorot-so-behtel-i-enka/>


39 <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32405038.html>

40 Ligji për kontrollin e brendshëm financiar publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 90/2009)

3.

Praktikat institucionale dhe zbatimi i ligjit

Lufta kundër korrupsionit mbetet një sfidë për Maqedoninë e Veriut, megjithëse vendi po ndërmerr një numër hapash në drejtim të harmonizimit të legjislacionit dhe krijimit të një organi të specializuar kundër korrupsionit me fuqi parandaluese dhe represive. Megjithatë, korrupsioni vazhdon të jetë një nga problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët. Edhe pse kuadri ligjor dhe institucional është kryesisht në përputhje me legjislacionin e BE-së, ka mungesë të rezultateve konkrete në luftën kundër korrupsionit.



3.1. Zhvillimet e përgjithshme institucionale

Në vitin 2020, në kuadër të Qeverisë së Zoran Zaevit, u promovua një funksion i ri zëvendëskryeministrot për luftë kundër korrupsionit, zhvillimin e qëndrueshëm dhe burimet njerëzore. Funksioni i ri u dha Sekretarit të Përgjithshëm të LSDM-së Ljupčo Nikolovski në rolin e koordinatorit midis institucioneve që luftojnë korrupsionin. Në vitin 2022⁴¹, me zgjedhjen e qeverisë së re të udhëhequr nga Kovačevski, ky post u riemërua **Zëvendëskryeministër i ngarkuar me politikat e qeverisjes së mirë** dhe e ushtron Sllavica Grkovska.

Ndaj ish-kryetares së **Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimet të Organizuar dhe Korrupsionit (PTHP-NKOK)**, **Vilma Ruskovska**, dhedy prokurorëve të tjerë për përcaktimin e përgjegjësisë nga Prokuroria Publike, është iniciuar procedurë disiplinore për shkak të dyshimit se qëllimisht dhe në mënyrë të pajustificuar kanë bërë gabim të madh profesional dhe kanë bërë shkelje disiplinore të Ligjit për prokurorinë publike, pas së cilës prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka marrë vendim për largim nga detyra e prokurorit publik. Pas pezullimit të Ruskovskës, në nëntor 2022, Këshilli i Prokurorëve Publikë emëron Islam Abazin si prokurorin kryesor publik të PTHP - NKOK Shkup⁴². Megjithatë, zgjedhjet ishin të diskutueshme sepse u publikuan fotografi të Abazit me zyrtarë të BDI-së, megjithëse ai më parë kishte mohuar kontaktet personale me partinë. KSHPK shprehu dyshime në lidhje me kriteret e përzgjedhjes dhe ekzistencën e ndonjë ndikimi⁴³.

Kryetarja e Këshillit Gjyqësor, Vesna Dameva, u shkarkua nga detyra në prill 2023⁴⁴. Shkarkimi i Vesna Damevës shkaktoi një sërë reagimesh dhe kërkesash për rishqyrtim të vendimit. Për këtë vendim ka reaguar edhe grupi Blueprint, i cili ka mbetur i habitur nga këmbëngulja që lënda të vendoset në rendin e ditës dhe të vendoset në lidhje me të, pa asnjë bazë për shkarkim⁴⁵. Dameva paraqiti ankesë penale në Prokurorinë Themelore Publike në Shkup dhe padi në Gjykatën Administrative në lidhje me vendimin për shkarkimin e saj. Denoncimi penal i referohet veprës penale të shpërdorimit të detyrës dhe autorizimit⁴⁶.

41 <https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nsp?param=6cc6791d-23cf-4cff-b4d1-969c4d329421>

42 Njoftim – SJORM (sjorm.gov.mk)

43 TV 24: Ivanovska me vërejtje për mënyrën e zgjedhjes së Abazit

44 Njoftim nga seanca e 438-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut - 26.04.2023 (sud.mk)

45 Reagime të ashpra pas shkarkimit të kryetarit të Këshillit Gjyqësor, kërkohet rishikim i vendimit | Meta.mk

46 ЕКСПРЕТСЕДАТЕЛКАТА НА СУДСКИОТ СОВЕТ ВЕСНА ДАМЕВА ПОДНЕСЕ КРИВИЧНА ПРИЈАВА ДО СКОПСКОТО ОБВИНИТЕЛСТВО И ТУЖБА ДО УПРАВНИОТ СУД ЗА НЕЈЗИНОТО РАЗРЕШУВАЊЕ - Сакам Да Кажам (sdk.mk)

3.2. Institucionet e specializuara kundër korrupsionit

Në periudhën e kaluar nuk ka pasur ndryshime në përcaktimin e mandatit të institucioneve kundër korrupsionit.

Në nivel qendror, **KSHPK** vepron si institucion i pavarur i specializuar kundër korrupsionit. KSHPK-ja paraqet raport vjetor për punën e saj në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në vitin 2021, KSHPK-ja mori ambiente të reja të zyrave, të cilat përbënin një zgjidhje për problemin e gjatë të Komisionit. Zyrat e reja janë të përshtatshme për instalimin e serverëve të nevojshëm për të lidhur KSHPK-në me 17 institucione nga të cilat do të jetë e mundur të jepet informacion mbi rastet e zbuluara në lidhje me korrupsionin ose konfliktin e interesit. Gjithashtu nga buxheti i shtetit janë dhënë 615.000 euro për mobilimin dhe modernizimin e zyrave.

Në vitin 2022 është rritur numri i të punonjësve në KSHPK, kështu që nga 64 vende pune të parashikuara nga sistematizimi, janë plotësuar 48, që paraqet 75% përmbushje dhe përmirësim të situatës me burimet njerëzore krahasuar me vitin 2021, kur përmbushja ishte 53%, d.m.th. janë plotësuar 34 vende pune.⁴⁷

KSHPK në korrik 2022 promovon Qendrën e Trajnimit, së bashku me platformën për *E-learning*⁴⁸, që synon të gjithë personat e interesuar të fitojnë njohuri të reja në fushën e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe integritetit.

Me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit me institucionet e tjera për të luftuar korrupsionin në mënyrë më efektive në periudhën e kaluar, KSHPK-ja nënshkroi disa memorandume bashkëpunimi, përkatësisht me Komisionin e Letrave me Vlerë, Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA), Këshillin e Inspektimit, etj. Gjithashtu, KSHPK-ja dhe Ministria e Punëve të Brendshme nënshkruan Marrëveshjen për Bashkëpunim dhe Shkëmbim të të Dhënave në Formë Elektronike dhe Memorandumin për Përmirësimin e Sistemit të Mbrojtjes së Sinjalizuesve, si një mjet efektiv në luftën kundër korrupsionit⁴⁹.

Si rezultat i rritjes së ndjeshmërisë, numri i raporteve të të gjitha formave të konfliktit midis interesit publik dhe privat po rritet. Në Tabelën 6 paraqiten gjendjet për denoncimet e pranuar me pretendime për ekzistim të konfliktit të interesit në tre vitet e fundit.

47 GI-2022-конечен.pdf (dksk.mk)

48 Sistemi për mësim në distancë e KSHPK-së (dksk.mk)

49 <https://dksk.mk/en/?s=%D0%BC%D0%B5%D0%BC%D0%BE%D1%80%D0%B0%D0%BD%D0%B4%D1%83%D0%BC>

Tabela nr. 6.*Rastet me pretendime për konflikt interesi*

Lëndët e formuara	Numri i rasteve të regjistruara		
	2022	2021	2020
Iniciativë personale	27	17	6
Denoncime nga qytetarët	118	89	80
Totali	145	106	86

Burimi: Raportet Vjetore të KSHPK-së

KSHPK-ja në vitin 2022 ka marrë vendime për 161 lëndë në krahasim me vitin 2021 kur ka marrë 152 vendime për veprime në fushën e konfliktit të interesit. Në të njëjtin vit, KSHPK-ja paraqiti 6 iniciativa në institucionet kompetente krahasuar me vitin 2021, kur paraqiti vetëm dy për iniciimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së personave zyrtarëve për shkak të konflikteve të interesit. Në të njëjtin vit, KSHPK-ja ka paraqitur dy nisma në krahasim me vitin 2021, kur nuk është paraqitur asnjë nismë për shkarkimin e zyrtarëve për shkak të konfliktit të interesit⁵⁰.

Veprimet e KSHPK-së në lidhje me inspektimin dhe konstatimin e situatave që kanë të bëjnë me dyshime për sjellje korruptive, konflikt interesash, parandalim të korrupsionit në politikë, mosdeklarim të pasurisë dhe interesave, kontroll të deklaratave të pasurisë etj; i mbështet ato në bazë të kërkesave të personave juridikë ose fizikë, anonimë ose të njohur, me informacion të pranuar, ose me iniciativë të tyre, por edhe sipas planeve vjetore. Gjatë vitit 2022, një numër i madh raportesh u dorëzuan në KSHPK për të gjitha arsyet e paraqitura në tabelën e mëposhtme⁵¹.

Tabela nr. 7.*Gjendja e lëndëve sipas denoncimeve të pranuar, vetiniciativa dhe vendimet e marra*

Fusha e veprimit	Korrupsioni		Konflikt i interesave		Gjendja pronësore		Financimi i fushatave zgjedhore		Totali	
	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021
Viti	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021
Raportimet e pranuar	563	583	118	89	17	51	0	48	698	771
Iniciativë personale	20	16	27	17	80	806	0	6	127	845
Nr. i vendimeve të marra	509	390	161	152	372	92	14	41	1056	675

Burimi: Raportet Vjetore të KSHPK-së

50 <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2023/03/GI-2022-%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%B5%D1%87%D0%B5%D0%BD.pdf>

51 GI-2022-конечен.pdf (dksk.mk)

KSHPK përpunon vazhdimisht listat anketuese të dorëzuara dhe përditëson të dhënat e ndryshimit për gjendjen pronësore.

Tabela nr. 8.

Listat anketuese për gjendjen pronësore

Listat anketuese të dorëzuara	2022	2021	2020
Totali	4.423	2.006	1.519

Burimi: Raportet Vjetore të KSHPK-së

Me planin vjetor të miratuar për monitorimin e gjendjes pronësore dhe konflikteve të interesit, u parashikua kontrolli i të dhënave për gjendjen pronësore dhe konfliktet e interesit të drejtorëve të ndërmarrjeve publike, drejtorëve të institucioneve shëndetësore publike, drejtorëve të inspektorateve, gjyqtarëve, prokurorëve dhe deputetëve⁵².

Gjithashtu, në bazë të raporteve të dorëzuara por edhe me iniciativën e saj, KSHPK formoi lëndë për të kontrolluar vërtetësinë e të dhënave në listat anketuese të dorëzuar nga personat e zgjedhur dhe të emëruar. Në vitin 2022 janë formuar 97 lëndë, krahasuar me 857 lëndë në vitin 2021.

Për shkak të zgjedhjeve lokale në vitin 2021, KSHPK-ja ka kryer një inspektim sistematik të personave të zgjedhur (kryetarëve të komunave, këshilltarë, drejtorë, etj.), si dhe të personave, mandati i të cilëve ka përfunduar për dorëzimin në kohë të listave anketuese pas përfundimit të funksionit. Në vitin 2021 janë formuar 753 lëndë, të cilat janë trajtuar në vitin 2022. KSHPK-ja lëshoi 372 urdhërpagesa për kundërvajtje, 317 vendime për ndërprerjen e procedurës dhe 56 kërkesa në Komisionin për kundërvajtje të KSHPK-së për fillimin e procedurave për kundërvajtje për shkak të mos pagesës së gjobës⁵³.

3.3. Mekanizmat kundër korrupsionit në proceset e vendimmarrjes

Kuvendi nuk ka komision të specializuar kundër korrupsionit. Një komision hetimor mund të krijohet në Kuvend nëse 20 deputetë (nga gjithsej 120) ngrenë çështje në lidhje me hetimin e përgjegjësisë për korrupsionin, i cili përfshin funksionarë të zgjedhur dhe të emëruar. Ky komision hetimor ka autoritetin të kërkojë dorëzimin e çdo dokumenti dhe materiali që mund të jetë i rëndësishëm për çështjen në fjalë, nga çdo person juridik ose përgjegjës përkatës. Në shtator 2023, Kuvendi vendosi ngritjen e një komisioni hetimor⁵⁴ për çështjen “Onkologjia”, pas informacioneve për keqpërdorimin me terapinë biologjike për pacientët onkologjikë dhe shitjen e saj, për të cilin rast tani është hapur hetim⁵⁵. Komisioni ngarkohet të analizojë të gjitha dokumentet në ISHP “Klinika Universitare për Radioterapi dhe Onkologji” me qëllim përcaktimin e përgjegjësisë politike të funksionarëve qeveritarë dhe shëndetësorë lidhur me

52 <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2022/03/02-7454-2.pdf>

53 GI-2022-конечен.pdf (dksk.mk)

54 Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 198/2023

55 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut - Detajet e materialit (sobranie.mk)

afërën. Komisioni hetimor do të përgatisë raporte që do t'i dorëzohen Qeverisë, KSHPK-së dhe Prokurorisë Publike.

Deputetët duhet të përmbushin të gjitha detyrimet, ashtu si edhe personat zyrtarë të tjerë të zgjedhur dhe të emëruar kur bëhet fjalë për deklarimin e pasurisë së tyre dhe deklaratat për konflikt të interesit.

Sa i përket funksionimit të Kuvendit, sipas sugjerimeve të BE-së, mbeten sfida në drejtim të planifikimit më efikas të procesit të miratimit të ligjeve. Përdorimi i procedurës “flamuri i BE-së” si procedurë e shkurtuar duhet të jetë i kufizuar dhe nuk duhet të përdoret për të shkurtuar konsultimet publike ose për të zgjidhur vështirësitë procedurale në dhomën ligjvënese.

3.4. Roli i organizatave të shoqërisë civile në përgatitjen e kuadrit ligjor kundër korrupsionit

Platforma e organizatave të shoqërisë civile për luftë kundër korrupsionit është përfshirë në procesin konsultativ të hartimit të strategjive dhe ligjeve në fushën e qeverisjes së mirë dhe luftës kundër korrupsionit. Organizatat e shoqërisë civile ishin pjesë e procesit të miratimit të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, si dhe në procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit (2021-2025). Gjithashtu, anëtarët e Platformës janë pjesë e grupeve të punës për ndryshimin e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, hartimin e Ligjit për shërbimin e lartë udhëheqës, ndryshimet në Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve, si dhe marrin pjesë në procesin e ndryshimeve të Strategjisë Kombëtare. Anëtarët e platformës u tërhoqën nga grupi i punës për hartimin e ligjit për konfiskimin e pasurisë në procedurë civile.

Lidhur me praktikën e publikimit të propozim - ligjeve në Regjistrin e Vetëm Kombëtar të Rregulloreve (ENER), megjithëse ministritë janë të detyruara të publikojnë propozim - ligjet në ENER që miratohen në procedurë të rregullt dhe të shkurtuar, ende ekziston një praktikë që shumë nga propozim - ligjet nuk janë publikuar në ENER dhe nuk janë në dispozicion për konsultim publik. Në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2022, gjithsej 191 propozim - ligje u dorëzuan në Kuvend, nga të cilat 86 u propozuan nga deputetët në Kuvend dhe nuk i nënshtrohen detyrimit të publikimit të tyre paraprak për ENER dhe zbatimit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës (VNR). 105 projektligjet e tjera të paraqitura u propozuan nga Qeveria dhe ministritë përkatëse dhe 65 prej tyre i nënshtrohen detyrimit për zbatimin e VNR-së, pra publikimit të tyre paraprak në ENER.

Lidhur me propozim - ligjet për të cilat ekziston detyrimi që të vendosen në ENER për konsultime (65), u konstatua se për 37%, përkatësisht në 24 raste, teksti i propozim - ligjit paraprakisht ishte publikuar në ENER. Ka një përqendrim të situatës në krahasim me vitet e mëparshme, përkatësisht në vitin 2021, 41% (48 propozim ligje) u vendosën në ENER për konsultim publik, dhe në vitin 2019 kjo përqindje ishte 49,56%⁵⁶.

56 Raporti vjetor i monitorimit të ENER për vitin 2022, [Pasqyra e Qeverisë: Pjesëmarrja e publikut në proceset e përgatitjes së ligjit \(rcgo.mk\)](#)

3.5. Organet e tjera të kontrollit shtetëror që kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit

3.5.1. Këshilli Inspektues

Këshilli Inspektues është institucioni kyç në sistemin e mbikëqyrjes inspektuese. Në vitin 2019, statusi i tij u ndryshua në organ të pavarur të administratës shtetërore, kompetenca kryesore e të cilit është monitorimi dhe koordinimi i funksionimit të shërbimeve të inspektimit në nivel qendror. Me nenin 18 të Ligjit për Mbikëqyrje inspektuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 102/19), janë listuar në mënyrë taksative të gjitha kompetencat e Këshillit, të cilat janë të lidhura, përkatësisht i referohen: shërbimeve të inspektimit në organet e administratës shtetërore, përkatësisht pushteti qendror; të gjithë inspektorëve, pavarësisht nëse janë të punësuar në shërbimet e inspektimit në organet e administratës shtetërore ose në njësitë e vetëqeverisjes lokale; dhe vetë Këshillit.

Tabela nr. 9.

Numri i inspektimeve të kryera dhe parregullsitë e zbuluara (nga inspektoratet)⁵⁷

Shërbimi Inspektues	I rregullt	I jashtëzakonshëm	Kontrollues	Gjithsej inspektime	Gjithsej parregullsi
Inspektorati shtetëror i tregut	3.820	18.428	6.528	28.776	8.300
Inspektorati Shtetëror i Punës	6.315	12.558	6.044	24.917	3.100
Inspektorati Shtetëror për Inspektim Teknik	898	91	57	1.046	36
Inspektorati Shtetëror Devizor	5	11	0	16	0
Inspektorati shtetëror për mjedis jetësor	1.369	349	382	2.100	369
Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor	3.430	1.732	708	5.870	578
Inspektorati Shtetëror i Transportit	2.563	681	457	3.701	1.310

57 Godishen-Izveshtaj-za-rabota-na-inspekciskite-sluzbi-2022-godina.pdf

Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm	51	66	5	122	6
Inspektorati Shtetëror Komunal	149	22	16	187	16
Inspektorati Shtetëror i Bujqësisë	2.095	44.135	640	46.870	844
Inspektorati Shtetëror i Pylltarisë dhe Gjuetisë	1.197	690	171	2058	252
Inspektorati Shtetëror i Arsimit	5.034	967	283	6284	477
Inspektorati Shtetëror Administrativ	432	1.394	667	2.493	873
Inspektorati Shtetëror i Vetëqeverisjes Lokale	1.191	82	6	1.279	8
Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve	82	14	4	100	91

Burimi: Raporti vjetor për punën e shërbimeve inspektuese për vitin 2022

3.5.2. Enti Shtetëror për Revizion

Sipas raportit vjetor të ESHR-së, në vitin 2022 janë kryer 188 revizione, nga të cilat 170 revizione të rregullsisë, 12 revizione të performancës dhe 6 revizione të pajtueshmërisë. Në vitin 2022, ESHR identifikoi 1,242 situata në 223 raporte revizioni⁵⁸. Gjatë vitit 2022 ESHR ka dhënë gjithsej 775 rekomandime. Sipas ligjit, institucionet janë të detyruara të zbatojnë rekomandimet e paraqitura në raportet e revizionit të ESHR-së. Kështu, përfaqësuesi ligjor i subjektit është i detyruar të informojë ESHR-në, për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve në raportet e revizionit në afat prej 90 ditë. ESHR-ja gjithashtu merr informacion nga institucionet për progresin e tyre në zbatimin e rekomandimeve. Në vitin 2022, për gjithsej 234 rekomandime nga ESHR-ja, u morën masa.

ESHR-ja informon rregullisht publikun duke publikuar raportet e tij vjetore, revizionet e kryera dhe raportet financiare, si dhe duke komunikuar me më shumë se 1.110 palë të interesuara. Në vitin 2022 janë bërë 512 njoftime për media për raportet përfundimtare të revizionit, nga të cilat 92 janë publikuar nga televizionet dhe 420 nga portalet e internetit.

58 https://dzt.mk/sites/default/files/2023-06/DZR_Godisen_izvestaj_2022_mkd_0.pdf

ESHR bën revizion të raporteve financiare, si dhe revizionin e pajtueshmërisë së SHA MEPSO për vitin 2021. Vëmendja më e madhe e publikut u tërhoq nga humbja e pothuajse 14 milionë eurove të operatorit. Konkretisht, në vitin 2021, është bërë rregullimi i vlerës për një pjesë të kërkesave sipas kontratave të riprogramuara nga BOS dhe për gjobat dhe dëmet për shkak të ndërprerjes së dorëzimit të energjisë elektrike të rënë dakord, në shumën prej 15 milionë euro. Një pjesë e detyrimeve, në shumën 1.2 milionë euro, është arkëtuar në vitin 2022⁵⁹.

Në vitin 2022, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ESHR-ja, nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit me qëllim të forcimit të aktiviteteve dhe shkëmbimit të informacionit midis këtyre dy institucioneve në fushën e forcimit të efikasitetit dhe transparencës së mbikëqyrjes financiare publike⁶⁰.

3.5.3. Drejtoria e të Ardhurave Publike

Drejtoria e të Ardhurave Publike (DAP) publikon raport vjetor për aktivitetet e saj çdo vit. Ky raport vjetor është në dispozicion të publikut. Përmban informacion të detajuar në lidhje me inspektimet, kontrollet dhe aktivitetet e tjera të kryera nga inspektorët tatimore, si dhe rezultatet e përfituara nga këto aktivitete. Kjo transparencë në raportim është thelbësore për të promovuar llogaridhënien dhe për të siguruar njohuri për përpjekjet dhe rezultatet e administratës tatimore.

Në kuadër të DAP-së ka një inspektorat tatimor që kryen mbikëqyrjen e inspektimit mbi subjektet private. Në vitin 2022 janë kryer gjithsej 2,544 kontrolle tatimore (TMA, TMP dhe TVSH). Janë evidentuar parregullsi në 1.215 raste, që paraqet 47,8% të numrit të përgjithshëm të kontrolleve të kryera. Gjithashtu, në vitin 2022 janë kryer 3.858 kontrolle dhe kontrolle të tjera në funksion (me përjashtim të gjetjeve tatimore). Kontrollet dhe kontrollet e tjera në funksion (duke përfshirë gjetjet tatimore) kanë të bëjnë me verifikimin e një shtate të veçantë faktike dhe rezultuan me konstatim⁶¹.

Tabela nr. 10.

Kontrollet e kryera, në bazë të tatimeve, sipas vitit

	2020	2021	2022
Numri i kontrolleve	2.745	3.031	2.544
Me parregullsi	1.307	1.363	1.215

Burimi: Raportet vjetore, DAP

Në vitin 2022, DAP gjeneroi të ardhura totale nga tatimet dhe kontributet sociale nga paga në shumën prej 198.01 miliardë denarë, që përfaqëson 99.67% të të ardhurave totale të planifikuara për vitin 2022⁶².

59 https://dzt.mk/sites/default/files/2023-06/DZR_Godisen_izvestaj_2022_mkd_0.pdf

60 https://dzt.mk/sites/default/files/2022-10/Memorandum_Sobranie_RSM_DZR.pdf

61 http://www.ujp.gov.mk/files/attachment/0000/1503/08-5075_1_Godisen_izvesta_na_UJP_za_2022.pdf

62 http://www.ujp.gov.mk/files/attachment/0000/1503/08-5075_1_Godisen_izvesta_na_UJP_za_2022.pdf

3.5.4. Drejtoria Doganore

Administrata Doganore publikon raport vjetor për aktivitetet e saj çdo vit, i cili është në dispozicion të publikut. Në raportet vjetore ka informacion të detajuar për inspektimet, kontrollet dhe aktivitetet e tjera të kryera nga inspektorët doganorë, si dhe për rezultatet e përfituara nga këto aktivitete.

Në vitin 2022 janë regjistruar 1.616 shkelje doganore dhe janë shqiptuar gjoba në lartësi prej 694.000 euro. Në vitin 2022, u ngritën gjithsej 32 kallëzime penale nga Njësia e Hetimeve për krimet e zbuluara gjatë kontrolleve. Në vitin 2022 janë filluar 14 hetime financiare për 22 individë dhe 9 subjekte juridike. Janë dorëzuar iniciativa në Prokurorinë Publike në lidhje me sigurimin e pajisjeve, ndërtesave të banimit dhe automjeteve në shumën totale prej 20.67 milion denarë.

Për më tepër, në vitin 2022 janë kryer gjithsej 165 kontrolle dhe hetime të brendshme. Nga këto, në 51 raste janë konstatuar parregullsi ose mospërputhje me rregulloret doganore. Në përgjigje të këtyre gjetjeve, janë marrë masa disiplinore, duke rezultuar në veprimet e mëposhtme⁶³:

- 5 paralajmërime me shkrim;
- 14 gjoba me para;
- 1 anulim të kontratës së punës; dhe
- 34 gjoba me para për vendime për uljen e pagës.

Në vitin 2022, Drejtoria Doganore mblodhi të ardhura në vlerë prej 119.15 miliardë denarë, që përfaqëson 48% të të ardhurave të mbledhura në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe 83% të të ardhurave totale të realizuara tatimore në vend. Drejtoria Doganore punon për digjitalizimin e punës doganore, si prioritet i Drejtorisë, me qëllim ofrimin e shërbimeve më efikase, shkëmbimin midis institucioneve, kontrolle më efikase dhe uljen e ekonomisë informale.

3.6. Prokurimet publike

Maqedonia e Veriut është mesatarisht e përgatitur në fushën e prokurimeve publike. Sipas BE-së, autoritetet kombëtare duhet të zbatojnë masa më efektive kundër korrupsionit në prokurimet publike. Ligji për partneritetin strategjik për ndërtimin e Korridorit 8 dhe një pjesë e Korridorit 10 i miratuar në vitin 2021 shkaktoi shqetësim për shkak të përjashtimit të projektit nga zbatimi i Ligjit për prokurime publike dhe dhënies së drejtpërdrejtë të kontratës pa procedurë konkurruese. Siç theksohet në raportin e BE-së, ekziston nevoja për të krijuar një shkëmbim efektiv të të dhënave dhe informacionit midis Byrosë për Prokurime Publike, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, ESHR-së dhe KSHPK-së⁶⁴.

Në vitin 2022, tregu i prokurimeve publike arriti në 8.6% të BPV-së, së vendit dhe përfaqësonte 25% të buxhetit të shtetit⁶⁵. Janë lidhur 28,313 kontrata për prokurime publike, në vlerë totale

63 Raporti vjetor 2022 pdf (customs.gov.mk)

64 North Macedonia Report 2022.pdf (europa.eu)

65 North Macedonia Report 2023

prej 68 miliardë denarë përkatësisht 1.1 miliardë euro. Vlera e prokurimeve në vitin 2022 u ul me 14% krahasuar me një vit më parë, përkatësisht me 11 miliardë denarë (179 milionë euro). Çdo e treta kontratë për prokurim publik në vitin 2022 është lidhur në një procedurë në të cilën ka marrë pjesë vetëm një kompani. Bëhet fjalë për 9.305 kontrata, në shumë të përgjithshme prej 26 miliardë denarë (427 milionë euro). Numri mesatar i ofertave të të gjitha procedurave për prokurime publike për vitin 2022 është 3 oferta për tender, që tregon një rënie të konkurrencës krahasuar me vitin 2021, kur janë dorëzuar mesatarisht 3.3 oferta për tender. Mungesa e konkurrencës rezulton në një rritje të rrezikut në tendera të mos merret vlera më e mirë për paratë e shpenzuara dhe një përqendrim i lartë i vlerës së tenderëve në një numër të vogël kompanish⁶⁶.

Arsyet për përkeqësimin e konkurrencës mund të grupohen në tre kategori kryesore, përkatësisht: kushtet diskriminuese të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, qëndrimi diskriminues i institucioneve që çojnë në rritjen e mosbesimit ndaj sektorit të biznesit dhe i dekurajojnë ata nga pjesëmarrja e ardhshme në prokurimin publik, dhe arsyet që rrjedhin nga specifikimet e favorshme teknike që përshkruajnë produktet e dëshiruara, në vend që të lejojnë konkurrencën midis ofertuesve⁶⁷.

Një nga treguesit kryesorë të problemeve në prokurimet publike është numri i lartë i anulimeve. Në vend që të ulet, numri i anulimeve në vitin 2022 u rrit me 2 p.p., krahasuar me vitin 2021 në 7,048. Çmimi më i ulët është përdorur si kriter për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme në procedurat e tenderit në 94% të tenderëve të zhvilluar në vitin 2022, njësoj si një vit më parë⁶⁸. Të dhënat tregojnë se përdorimi i një procedure me negociim pa publikim paraprak të një shpallje u ul në 6,6% në vitin 2022, nga 8% në vitin 2021⁶⁹. Parë në nivel institucionesh, dy të tretat e vlerës së kontratave të lidhura pa shpallje i përkasin SH.A> termocentraleve⁷⁰.

Raporti i vitit 2022 nuk është publikuar ende në faqen e internetit të Byrosë për Prokurime Publike.

Në vitin 2022, ESHR rishikoi vlerën prej 2.95 miliardë denarë ose 48.5% të vlerës totale të kontratave të dhëna për prokurime publike në 333 subjekte të përfshira nga revizionet dhe identifikoi parregullsi me vlerë 0.99 miliardë denarë ose 33% të prokurimeve publike të audituara⁷¹.

Parregullsitë lidhen kryesisht me dobësitë në zbatimin e kontratave të lidhura për prokurime publike, procedurat e pazbatuara për prokurime publike, dobësitë në planifikimin e prokurimeve publike, parregullsitë në përgatitjen e dokumentacionit/specifikimit teknik të tenderit, dobësitë në vendimmarrjen për prokurimet publike dhe elementët kufizues të përfshira në dokumentacionin e tenderit në lidhje me konkurrencën.

66 38mk.pdf (ccc.org.mk)

67 Ibid.

68 Ibid.

69 North Macedonia Report 2023

70 Ibid.

71 DZR_Godisen_izvestaj_2022_mkd_0.pdf

4.

Gjyqësori dhe lufta
kundër korrupsionit



Sistemi maqedonas i drejtësisë aktualisht po përballet me sfida të rëndësishme, veçanërisht me menaxhimin dhe shpërndarjen e lëndëve. Analiza e përgatitur nga Këshilli Gjyqësor, për të treguar numrin optimal të gjyqtarëve, identifikon mungesën e më shumë se 60 gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Lartë Administrative dhe katër gjykatat e apelit në vend⁷². Vetë Këshilli Gjyqësor, i cili garanton autonominë dhe pavarësinë e gjyqësorit, kohët e fundit ka pësuar ndryshime në strukturën e brendshme që gjyqësori dhe ekspertët ligjorë i kanë vlerësuar si të paligjshme dhe mund të kenë ndikim negativ në besueshmërinë e tij⁷³. Më pas, Ministria e Drejtësisë, në nëntor 2023, filloi krijimin e një grupi pune për të reformuar Këshillin Gjyqësor dhe për të kapërcyer dobësitë në drejtim të zgjidhjeve ligjore dhe zbatimit të tyre në praktikë⁷⁴. Gjithashtu, Komisioni për Mbikëqyrjen e Funksionalitetit të Sistemit ACMIS në gjykata, evidenton mospërputhje të plotë me dispozitat ligjore për përfshirjen dhe përjashtimin e gjyqtarëve dhe arkivimin jo të vazhdueshëm të lëndëve⁷⁵.

Paralelisht, Prokuroria Publike përballet me sfidat e veta, siç është dalja në pension e 10 prokurorëve që plotësojnë kushtet për pensionim të moshës në qershor 2022.⁷⁶ Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, e cila ka trashëguar lëndët nga ish-Prokuroria Speciale Publike (PSP), ende nuk është zhvendosur në ambientet e saj të reja, ka buxhet dhe numër të pamjaftueshëm të të punësuarve dhe aktualisht punon me vetëm 14 prokurorë. Kjo ndikon në efikasitetin e këtij institucioni në luftën kundër korrupsionit dhe krimin, e përkeqësuar më tej nga mungesa e një sistemi elektronik të ndarjes së lëndëve të parashikuar nga Ligji për prokurorinë publike të vitit 2020. Gjithashtu, ndryshimet e fundit në Kodin penal kanë implikime mbi lënëdet aktuale, duke prekur rreth 200 të pandehur në 26 lëndë gjyqësore të proceduara për shpërdorim detyrë⁷⁷. Në përgjithësi, gjyqësori në Maqedoninë e Veriut përballet me sfida në lidhje me ruajtjen e besueshmërisë, ndarjen e lëndëve, pajisjet e pamjaftueshme teknike dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, të cilat kërkojnë reforma gjithëpërfshirëse për funksionimin e tij efektiv dhe transparent.

Sipas të dhënave të publikuara nga ESHR-ja, në lidhje me veprat penale kundër detyrës zyrtare, mund të vërehen luhatje në numrin e rasteve të raportuara në baza vjetore, me numrin më të lartë të raportimeve në vitin 2019 (740) dhe një rënie të mëvonshme në vitet pasuese, ndërsa numri i akuzave është më i larti në vitin 2022 (147) dhe më i ulëti në vitin 2019 (87). Trendi për sa i përket numrit të vendimeve gjyqësore është i ngjashëm, i cili është gjithashtu më i lartë në vitin 2022 (98) dhe më i ulët në vitin 2019 (53).

72 <https://360stepeni.mk/analiza-na-sudskiot-sovet-vo-chetirite-apelatsiski-suda-vo-zemjava-nedostigaat-vkupno-49-sudii-najmnogu-vo-skopskiot/>

73 <https://www.dw.com/mk/kredibilitetot-na-sudskiot-sovet-na-test-raste-ritisokot-za-ostavki-i-odgovornost/a-65479452>

74 <https://www.pravda.gov.mk/vest/6615>

75 <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32572519.html>

76 Analiza, Vlerësimi Gjithëpërfshirës i Zbatimit të Strategjisë për Reformën në Sektorin Gjyqësor (2017-2022), INSTITUTI I Politikave Evropiane EPI.

77 <https://www.dw.com/mk/so-izmenite-na-krivicniot-zakonik-se-zasegnati-197-obvineti-vo-36-sudski-procesi/a-67153343>

Tabela nr. 12.*Vepra penale kundër detyrës zyrtare*

Fazat e procedimit penal	2022	2021	2020	2019
Raportime	495	487	516	740
Akuza	147	129	105	87
Vendime gjyqësore	98	80	75	53

Burimi: Baza e të dhënave të Makstat


Ndryshimet në Kodin penal (neni. 394 - Shoqërim kriminal dhe neni 353 - Keqpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar), me të cilët shlyhen paragrafët dhe parashikohen dënime më të ulëta për veprat penale të kryera me korrupsion, kanë ndikim mbi hetimet dhe lëndët gjyqësore në vazhdim. Nuk ka pothuajse asnjë aktakuzë nga rastet më të mëdha të ish PSP-së që nuk preket nga këto ndryshime ligjore. Konkretisht, për gjithsej 14 lëndë gjyqësore, për të cilat janë akuzuar mbi 80 persona, do të ketë parashkrim absolut për ndjekje penale. Disa prej tyre janë raste lidhur me prokurimin e pajisjeve për Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK) në rastin “Thesari”, rasti për ndërtimin e autostradave “Trajektorja”, rasti për përgjimin masiv “Target-kështjella” dhe dy rastet “Talir” për financim të paligjshëm të partisë politike⁷⁸.

Ndryshimet inkurajojnë mbylljen e lëndëve të shumta, duke liruar potencialisht një numër të konsiderueshëm ish-funksionarë nga ndjekja penale. Ndryshimet jo vetëm që prekin hetime specifike, por gjithashtu ngrenë shqetësime më të gjera në lidhje me pasojat e mundshme për procedurat ligjore në vazhdim dhe zbatimin e përgjithshëm të ligjeve që lidhen me korrupsionin dhe shpërdorimin e pushtetit.

78 <https://prizma.mk/zakonski-izmeni-za-atentat-na-slucaite-za-zloupotrebi-na-sjo/>

5.

Korrupsioni dhe ekonomia



5.1. Situata në vend

Ekonomia e Maqedonisë së Veriut është prekur ndjeshëm nga recesioni i shkaktuar nga pandemia covid-19 dhe nga kriza e fundit energjetike, e nxitur nga pushtimi rus i Ukrainës dhe varësia e madhe e Maqedonisë së Veriut nga importet e karburantit dhe energjisë elektrike. Këto rrethana kontribuuan në një hendek të konsiderueshëm financiar në vend. Për të mbështetur stabilizimin ekonomik të Maqedonisë së Veriut dhe një agjendë të konsiderueshme reformash, BE njoftoi ndihmë mikro-financiare në formën e kredive me vlerë 100 milion euro⁷⁹.

Sipas të dhënave të vlerësuara të ESHR-së, në vitin 2022 BBV-ja reale u rrit me 2.1%, që është një ngadalësim krahasuar me rritjen prej 3.9% në vitin 2021. Gjegjesisht, gjatë vitit 2022, dolën në pah efektet negative të konfliktit ushtarak në Ukrainë, të cilat imponuan sfida të reja globale në lidhje me krizën energjetike dhe normat e larta të inflacionit, të cilat rezultuan me një ngadalësim të rritjes ekonomike. Në vitin 2022, inflacioni u përshpejtua, me normën mesatare të inflacionit që arriti në 14,2%. Faktori kryesor për lëvizjet më të theksuara në rritje të çmimeve të brendshme është rritja historikisht e lartë e çmimeve të importuara të ushqimit dhe energjisë. Këto ndryshime lidhen kryesisht me ndërprerjen post-pandemike të zinxhirëve globalë të furnizimit, si dhe efektet e luftës në Ukrainë. Kalimi i një pjese të të papunëve në popullatën joaktive është arsyeja kryesore për një rënie të mëtejshme të shkallës së papunësisë, e cila në vitin 2022 ra në nivelin historikisht më të ulët prej 14.4% (rënie vjetore me 1.1 p.p.)⁸⁰. Sipas *Ease of Doing Business* të Bankës Botërore, Maqedonia e Veriut renditet e 17-ta me 80.7 pikë⁸¹.

Sipas të dhënave të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), pjesa e ekonomisë informale në sektorin e përgjithshëm ekonomik të Maqedonisë së Veriut është 37.6%⁸². Sipas këtyre të dhënave, vendi renditet i katërti në rajonin e Evropës Juglindore.

Sipas të dhënave të ESHR-së, punësimi informal si një segment i ekonomisë informale ka rënë si në terma absolutë, ashtu edhe si përqindje e punësimit formal, që nga viti 2008.

79 <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2023/07/10/council-adopts-100-million-assistance-to-north-macedonia/>

80 Raporti vjetor-2022-NB.pdf (nbrm.mk)

81 Doing Business in North Macedonia - World Bank Group

82 Министерство-за-финансии-и-органи-во-состав_-Анциски-план-за-сузбивање-на-сивата-економија-2021-2022.pdf (vnesiboja.mk)

Tabela nr. 13.

Punësimi formal dhe joformal, sipas grup-moshave, sipas viteve

Grupet e moshës	2021			2022		
	Totali	Të punësuar zyrtarisht	Të punësuar joformalisht	Totali	Të punësuar zyrtarisht	Të punësuar joformalisht
15-24	42.894	35.603	7.291	40.127	33.036	7.091
25-34	194.272	175.502	18.770	153.763	137.028	16.736
35-44	232.082	208.075	24.007	192.776	174.668	18.108
45-54	195.947	172.988	22.959	172.269	153.518	18.751
55-64	120.485	103.979	16.506	122.921	106.805	16.116
65 +	9.406	2.788	6.618	10.177	2.660	7.518
Totali	795.086	698.935	96.151	692.033	607.715	84.320

Burimi: Baza e të dhënave të Makstat ⁸³

Të dhënat tregojnë se në vitet 2021 dhe 2022, nga 100 punonjës në vend, janë punësuar në mënyrë informale 12 persona.


Sipas të dhënave nga SMK-së, në vitin 2023, 45,4% e të anketuarve deklaruan se kanë një punë bazë të paguar, ndërsa 9,5% e tyre gjithashtu punojnë punë shtesë të paguar.

Dyelementë kryesorë të punësimit informal janë puna pa kontratë me shkrim midis punëmarrësit dhe punëmarrësit me pagë më të lartë se ajo e përcaktuar në kontratën e nënshkruar dhe i nënshtrohet marrëveshjes së dakordësuar midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Sipas të dhënave të hulumtimit, 86,8% e të anketuarve kanë kontratë me shkrim me punëdhënësin e tyre dhe 3,4% janë përgjigjur se nuk kanë kontratë me shkrim. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se 33,0% e lartë e të anketuarve deklaruan se marrin një pagë më të lartë se ajo e rregulluar në kontratën me punëdhënësin e tyre.

83 Punësimi formal dhe joformal, sipas grup-moshave, sipas viteve. PxWeb (stat.gov.mk)


Figure 19.
Punëtorët që marrin pagë më të lartë se ajo e përcaktuar në kontratën me punëdhënësin



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Sipas të dhënave të hulumtimit, shumica e të anketuarve kanë kontribute të paguara në vendin e tyre të punës (86.7%), dhe vetëm një pjesë e vogël (4.5%) deklaruan se nuk kanë kontribute të paguara në vendin e punës.


Figure 20.
Punëtorët me kontribute të paguara në punën bazë



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Ekzistojnë mekanizma dhe praktika të ndryshme kur bëhet fjalë për pagesën e kontributeve të pagës në vendin e punës nga punëdhënësit. Shifrat e hulumtimit tregojnë se 22.2% e të anketuarve raportuan se kontributet e tyre janë paguar në bazë të një page më të ulët ose në bazë të pagës minimale ligjore, megjithëse kompensimi aktual financiar për punën e tyre është më i lartë.

Figure 21.
Baza për kontributet e paguara në vendin kryesor të punës



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Disa fusha kanë një ndjeshmëri më të madhe ndaj informalitetit, siç janë punëtorët në sektorin bujqësor, të cilët punojnë në ferma dhe pronat e tyre familjare. Sipas hulumtimit, 10.9% e të anketuarve punojnë në fermat dhe pronat bujqësore familjare. Gjithashtu, 4.4% kanë kryer shërbime me pagesë për miqtë, të afërmit apo të njohurit e tjerë.

5.2. Masat në luftën kundër ekonomisë informale

Në vitin 2018, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS), u publikua Strategjia për Formalizimin e Ekonomisë Informale 2018-2022⁸⁴, e cila kishte për qëllim krijimin e parakushteve themelore për rritje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme ekonomike, një standard më të lartë jetese dhe një mjedis të favorshëm biznesi dhe për sigurimin e kushteve të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit e tregut, për mbështetje të transformimit të aktiviteteve ekonomike informale në ato formale, si dhe për parandalimin e flukseve të paligjshme të parave.

Në fund të vitit 2021, nisi fushata “Vendos ngjyrë në ekonominë gri”, me qëllim ndërgjegjësimin për pasojat e veprimtarive ekonomike të paregjistruara në cilësinë e jetës së çdo qytetari, si dhe inkurajimin e reduktimit të tyre⁸⁵. Fushata gjithashtu do të ketë një rol edukativ në atë që qytetarët do të jenë në gjendje të informohen se çfarë është ekonomia gri, si mund ta njohin atë dhe cilat janë pasojat e mbështetjes së saj. Ministria e Financave së bashku me organet përbërëse punuan gjithashtu për plotësimin e Planit të Veprimit për Çrrënjosjen e Ekonomisë Gri me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin për pasojat e ekonomisë gri dhe nevojën për zvogëlimin e saj⁸⁷.

Plani i Veprimit për Çrrënjosjen e Ekonomisë Gri përfshin disa prioritete: rritjen e procesit të matjes, monitorimit dhe zbulimit të ekonomisë gri, stimulimin e aktiviteteve për formalizimin e ekonomisë gri, forcimin e ndërgjegjësimin për ekonominë gri dhe forcimin e moralit tatimor, forcimin e shërbimeve të inspektimit, rritjen e legjislacionit, si dhe zbatimin e masave në fushën e Drejtorisë Doganore, ku do të mbulohen edhe produktet e tregtisë elektronike.

Ministria e Financave njoftoi se lufta kundër ekonomisë gri është pjesë e reformës së financave publike. Me ndryshimet sistematike do të ndërmerren një sërë masash për formalizimin e sektorit informal. Plani i veprimit për çrrënjosjen e ekonomisë gri mbulon të dy anët e sektorit informal – ofertën dhe kërkesën. Stimulimet, masat parandaluese për kalimin në produkte dhe shërbime formale, nxitja e efikasitetit të inspektimeve dhe mbikëqyrjes janë mekanizmat për luftimin e ekonomisë informale⁸⁸. Si pjesë e fushatës, u hap një linjë telefonike “198” për të raportuar ekonominë gri.

Me qëllim vazhdimin dhe përmirësimin e kuadrit dhe politikave për reduktimin dhe formalizimin e ekonomisë joformale, në vitin 2023 u miratua Strategjia e re për Formalizimin e Ekonomisë Joformale (2023-2027) dhe Plani i Veprimit⁸⁹, i përgatitur përmes bashkëpunimit ndër-sektorial, të cilat bazohen në një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e ekonomisë joformale. Gjithashtu, Qeveria me vendim krijon Këshillin Kombëtar për Formalizimin e Ekonomisë Informale i përbërë nga 20 anëtarë, përfaqësues të nivelit më të lartë nga institucionet, kompetencë e të

84 Strategjia për formalizimin e ekonomisë joformale në Republikën e Maqedonisë 2018-2022.doc (live.com)

85 Vnesi Boja – Vnesi boja vo sivata ekonomija

86 Vendosni ngjyrë – fushatë për të rritur ndërgjegjësimin për pasojat e ekonomisë gri - Ministria e Financave (finance.gov.mk)

87 Министерство-за-финансии-и-органи-во-состав_-Акциски-план-за-сузбивање-на-сивата-економија-2021-2022.pdf (vnesiboja.mk)

88 Besimi: Një sërë masash për të çrrënjosjen e ekonomisë gri, pjesë e reformës - Ministria e Financave (finance.gov.mk)

89 Strategjia-za-neformalna-ekonomija-2023-2027_korekcija-28082023-2-1.docx (live.com)

cilëve janë aktivitetet për reduktimin e ekonomisë informale. Roli i Këshillit është të drejtojë masat dhe aktivitetet në përputhje me Strategjinë dhe Planin e Veprimet. Qëllimi në periudhën afatmesme, përkatësisht deri në vitin 2027, është ulja e ekonomisë informale me 9 p.p., si rezultat i veprimeve të ndërmarra⁹⁰.

Si masë për reduktimin e ekonomisë gri në vitin 2019 me vendim ligjor, Qeveria filloi projektin “TVSH-ja ime”, me të cilin të gjithë ata që janë regjistruar në sistemin e-Tatim personal, përmes aplikacionit online TVSH-ja ime, kanë mundësi të skanojnë barkodin nga faturat fiskale dhe të ushtrojnë të drejtën e rimbursimit prej 20% për mallrat dhe shërbimet maqedonase, përkatësisht 10% për mallrat dhe shërbimet e tjera nga shuma e TVSH-së së paguar.

Projekti “TVSH-ja ime” ka funksionuar me sukses për katër vjet, dhe që nga prilli i vitit 2023 rimbursimi tremujor është rritur nga 1,800 në 2,100 denarë.⁹¹ Rritja e kësaj shume kërkon të rrisë motivimin e qytetarëve për të skanuar llogaritë dhe për të ndikuar në luftën kundër ekonomisë gri.

“TVSH-ja ime” si masë është vlerësuar si efektive në rritjen strukturore të të ardhurave nga TVSH-ja. Sipas llogaritjeve të *Finance Think*, vendosja e masës “TVSH-ja ime”, kontribuoi mesatarisht në të ardhura më të larta nga TVSH-ja në volumnin 3.1%, dhe mesatarisht do të reduktohej rreth 10% e volumnit të ekonomisë informale, përkatësisht do të transferohej në ekonominë formale me masën “TVSH-ja ime”, e cila është ekuivalente me 2.3 p.p. të volumnit të ekonomisë informale⁹².

Si masë për luftë kundër ekonominë joformale në periudhën nga **1 qershori 2019 deri më 26 dhjetor 2019**, në përputhje me Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 120/18), u **ndalua pagesa me para në dorë për mallra dhe shërbime në shumën prej 500 EUR ose më shumë në kundërvlerë në denarë në** formën e një ose më shumë transaksioneve të lidhura, të cilat nuk u kryen përmes një banke, shtëpie kursimi ose përmes një llogarie me një institucion tjetër që ofron shërbime pagese. Me ndryshimet plotësuese të ligjit, në të njëjtin vit (**Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 275/2019**), u bë një ndryshim dhe u mundësua të paguhej me para në dorë në vlerë deri në 3,000 euro në kundërvlerë në denarë (në vend të shumës së përcaktuar më parë prej 500 euro), e cila u vlerësua nga ekspertët si një reterim serioz nga lufta kundër ekonomisë joformale⁹³.

90 Takim koordinues në Ministrinë e Financave dhe përgatitjet për Këshillin Kombëtar për formalizimin e ekonomisë joformale - Ministria e Financave (finance.gov.mk)

91 Drejtoria e të Ardhurave Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ujp.gov.mk)

92 PolicyBrief_no.-62-MK.pdf (financethink.mk)

93 120751_GRI_PJESA_E_EKONOMISË_MAQEDONASE_-_MADHËSIA,_IMPLIKIMET,_zgjidhjet.pdf (mchamber.mk)

6.

Shoqëria civile në luftën
kundër korrupsionit



6.1. Aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile për antikorrupsionin

Në fund të vitit 2022, gjithsej 11,507 organizata u regjistruan në Maqedoninë e Veriut me gjithsej 1,742 punonjës, sipas të dhënave të paraqitura nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut (RQRMV)⁹⁴.

Ka një sërë organizata të shoqërisë civile që janë të angazhuara në avokim dhe ofrimin e shërbimeve. Sa i përket punës kundër korrupsionit, në vitin 2014, 15 organizata të shoqërisë civile, të cilat u rritën në 18 në vitin 2023, u bashkuan për të ndërtuar Platformën e Organizatave të Shoqërisë Civile për Luftë kundër Korrupsionit. Platforma është aktive në aktivitetet e përbashkëta për reformat legjislative kundër korrupsionit, merr pjesë në grupet e punës për ndryshimet legjislative në fushën e masave anti-korrupsion, qeverisjes së mirë dhe anëtarët e saj bashkëpunojnë me institucionet shtetërore, veçanërisht me KSHPK-në⁹⁵.

Tre institucione dhe mekanizma kryesorë janë përgjegjës për lehtësimin e bashkëpunimit midis Qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile në përgjithësi: Këshilli për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile dhe Qeverinë, Njësia për Bashkëpunim me OJQ-të dhe rrjeti i nëpunësve publikë për monitorimin e zbatimit të Strategjisë. Sipas rezultateve të anketës së organizatave të shoqërisë civile në vitin 2022, 61.6% e tyre janë të informuara për aktivitetet operacionale të Këshillit, ndërsa 29% e të informuarve për Këshillin pajtohen me pretendimin se vendimet e Këshillit bazohen në rekomandimet dhe kontributet e organizatave të shoqërisë civile⁹⁶. Sipas të njëjtit rezultat të anketës, 36% e organizatave të shoqërisë civile e konsiderojnë Këshillin si një organ përkatës për bashkëpunim dhe ndikim në politikëbërje. Nuk ka asnjë organ specifik për bashkëpunim midis organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore vetëm për masat anti-korrupsion, megjithatë, ka përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile për demokraci dhe qeverisje të mirë brenda Këshillit për Bashkëpunim.

Në vitin 2022, filloi procesi i ndryshimeve në Ligjin për shoqatat dhe fondacionet (LSHF) dhe u krijua një grup pune në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Megjithatë, në procesin e punës me grupin e deputetëve paraqitën ndryshime në LSHF që u pranuan me procedurë të përsheptuar. Amendamentet e miratuara ndalojnë shoqatat dhe fondacionet civile të përdorin emra dhe pseudonime të lidhura me fashizmin, nazizmin, gjenocidin, Rajhun e Tretë, etj. Ndryshimet në LSHF parashikojnë që: regjistrimi i një organizate dhe krijimi i një organizate ndalohet nëse titulli, emri, emri i shkurtuar, programi, objektivat, aktivitetet dhe veprimi i tyre kanë për qëllim shkatërrimin e dhunshëm të rendit kushtetues të Maqedonisë së Veriut, fillimin e agresionit ushtarak dhe nxitjen e urrejtjes kombëtare, racore, fetare ose llojit tjetër të intolerancës, urrejtjes, gjenocidit ose mbështetjes, nxitjen dhe miratimit të fashizmit, nazizmit, socializmit kombëtar dhe Rajhut të Tretë, ndërmarrjen e aktiviteteve në lidhje me terrorizmin, ndërmarrjen e aktiviteteve që janë në kundërshtim me Kushtetutën ose ligjin dhe ndërmarrjen e aktiviteteve që shkelin liritë dhe të drejtat e personave të tjerë. Ajo që është veçanërisht e rëndësishme është se ligji ka efekt retroaktiv dhe u referohet shoqatave dhe fondacioneve që janë regjistruar tashmë dhe u kërkohet brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve në ligj të harmonizojnë emrin e tyre dhe/ose emrin e shkurtër, programin, objektivat dhe aktivitetet në Regjistrin Qendror të Maqedonisë së Veriut.

94 Të dhënat e siguruara nga CRNM përmes kërkesës për informata me karakter publik

95 <https://www.antikorupcija.mk/en/%d0%b8%d1%81%d1%82%d0%be%d1%80%d0%b8%d1%98%d0%b0>

96 Raport për Mjedis Mundësues për organizatat e shoqërisë civile 2022

Shumë organizata të shoqërisë civile vazhdojnë të kenë donatorë të huaj si burim financimi, veçanërisht kur bëhet fjalë për aktivitete që lidhen me luftën kundër korrupsionit. Financimi shtetëror vazhdon të jetë një burim i panjohur të ardhurash për organizatat e shoqërisë civile dhe është në dispozicion vetëm për një numër të kufizuar organizatash⁹⁷. Në tre vitet e fundit, pjesa e financimit shtetëror nga niveli qendror në të ardhurat totale të organizatave të shoqërisë civile mbetet rreth 5%⁹⁸. Sipas Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile, kjo përqindje duhet të rritet gradualisht në 30%.

6.2. Mediat

Maqedonia e Veriut është midis një niveli të caktuar dhe të moderuar të gatishmërisë për sa i përket lirisë së shprehjes. Shikuar në përgjithësi, ka pasur përparim të kufizuar. Konteksti i përgjithshëm është i favorshëm për lirinë e medias dhe lejon raportimin kritik nga mediat. Ndryshimet në Kodin penal dhe Ligjin për përgjegjësi qytetare në lidhje me shpifjen kanë rritur shkallën e mbrojtjes juridike të gazetarëve. Megjithatë, janë regjistruar një numër sulmesh, kërcënimesh dhe disa frikësime të gazetarëve, vëren Komisioni Evropian në raportin e fundit për vendin, për vitin 2023, në pjesën për lirinë e medias.⁹⁹

Sa i përket frikësimit të gazetarëve, Komisioni Evropian tregon se vitin e kaluar Ministria e Brendshme regjistroi 17 raste të sulmeve ndaj gazetarëve dhe ka nisur hetime ndaj tyre. Shoqata e Gazetarëve regjistroi 14 incidente, të cilat përfshinin gazetarë, katër prej tyre me sulme fizike ose paraburgim të paligjshëm, si dhe 11 me sulme verbale, kërcënime dhe forma të tjera të frikësimit. Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe shoqatat e mediave, vëren KE, i dënon rregullisht incidentet e tilla⁹⁹.

Zhvillimet e fundit në lidhje me procesin kundër Laboratorit të Gazetarisë Investigative (IRL), të cilët punojnë gazetari të plotë investigative në fushën e luftës kundër korrupsionit, minojnë parimet dhe liritë themelore të organizatave të shoqërisë civile dhe medias në vend¹⁰⁰. IRL u dënua për shpifje për deklarimin e dyshimeve për korrupsion dhe pavarësisht dënimit për shpifje, gjykata lejoi veten të interpretojë dhe kontestojë veprimtarinë e tyre gazetareske. Pamundësimi i mendimit kritik për fenomene të caktuara sociale bie ndesh drejtpërdrejt me parimet e demokracisë dhe qeverisjes së mirë, ndaj të cilave reagoi sektori civil. Minimi i këtyre postulateve krijon vetëm institucione të mbyllura dhe të kapura që nuk marrin përgjegjësi për aktivitetet e tyre negative¹⁰¹.

Sipas të dhënave nga SMK, qytetarët vazhdojnë të përdorin mënyrën më tradicionale të raportimit, televizionin, për t'u informuar për çështjet e përditshme socio-politike me 62.9%, pasuar nga rrjetet sociale, si Facebook, Twitter, etj., me 62.4%.

97 Raport për Mjedis Mundësues për organizatat e shoqërisë civile 2022

98 <https://www.otcetnigo.mk/wp-content/uploads/2021/09/Infografik-04.jpg>


99 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2023_en

100 <https://irl.mk/irl-ne-se-osudeni-za-kleveta-osudeni-se-zatoa-shto-postojat/>

101 <https://mcms.mk/mk/vesti-i-javnost/vesti/2502-gragjanskite-organizacii-ostro-ja-osuduvaat-presudata-protiv-irl-za-kleveta-i-baraat-da-se-utvr-di-odgovornost-za-donesuvanjeta-na-istata.html>

Figura nr. 22.

Përdorimi i mediave të ndryshme për informim për çështje të caktuara dhe ngjarje të përditshme



Burimi: Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2023

Maqedonia e Veriut renditet e 38-ta nga 180 vende në botë sipas Indeksit Global të Lirisë së Mediave të “Reporterë pa Kufij”. Vendi kërceu me 19 vende në krahasim me vitin 2022 dhe është pozicionuar më mirë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. “Reporterë pa Kufij” deklarojnë në raportin e tyre për Maqedoninë e Veriut se megjithëse gazetarët nuk punojnë në një mjedis armiqësor, dezinformimi i përhapur dhe mungesa e profesionalizmit kontribuojnë në rënien e besimit të shoqërisë në media, gjë që i ekspozon mediat e pavarura ndaj kërcënimeve dhe sulmeve. Tendenca e zyrtarëve qeveritarë për të pasur qëndrime të këqija dhe poshtëruese ndaj gazetarëve vazhdon¹⁰².

102 <https://rsf.org/en/index>

7.

Bashkëpunim
ndërkombëtar



Institucionet ndërkombëtare luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm të politikave kundër korrupsionit, nga disa këndvështrime, duke filluar nga monitorimi dhe vlerësimi i përgjithshëm, duke vazhduar të mbështesin forcimin e institucioneve dhe mbështetjen për shoqërinë civile. Në dy vitet e fundit, ka pasur rritje të mbështetjes financiare nga komuniteti i donatorëve brenda fushave tematike: qeverisja e mirë dhe antikorrupsioni. Konkretisht, sipas të dhënave nga Baza Qendrore e të Dhënave për Ndhimë të Huaja (CDAD) e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të marra përmes Kërkesës për Qasje në Informata me Karakter Publik¹⁰³ nga Sekretariati për Çështje Evropiane (SÇE), në periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.10.2023, në këto fusha tematike është regjistruar ndihmë e huaj në vlerë prej 575 milionë denarë.

Më saktësisht, në vitin 2022 janë regjistruar 120 milionë denarë, ndërsa në vitin 2023, që nga tetori, janë regjistruar 455 milionë denarë. Donatori më i madh është USAID-i dhe Ambasada e SHBA-së në Shkup me mbështetje në vlerë prej 404 milionë denarë. Menjëherë pas kësaj është BE-ja me 158 milion denarë, dhe mbështetje prej 7.4 milion denarë nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Norvegjisë, si dhe 2.8 milion denarë nga UNHCR, është gjithashtu e rëndësishme. Pjesa tjetër e mjeteve financiare të regjistruara përfaqësojnë më pak mbështetje ndërkombëtare ose bilaterale. Ndryshe nga më parë ku mbështetja e donatorëve synonte kryesisht forcimin e institucioneve shtetërore si aktorë kryesorë anti-korrupsion, vitet e fundit komuniteti i donatorëve ka rritur mbështetjen edhe për aktorët e tjerë. Një shembull është programi “Qytetarët kundër korrupsioni” (*Citizens Against Corruption Activity*)¹⁰⁴, i mbështetur nga USAID, dhe i zbatuar nga QMBN. Ky program synon të rrisë angazhimin dhe bashkëpunimin e qytetarëve, shoqërisë civile, medias dhe sektorit privat në luftën kundër korrupsionit. Programi filloi me zbatim në prill 2023 dhe do të zbatohet për një periudhë prej 5 vjetësh, dhe buxheti i përgjithshëm është 345.5 milion denarë. BE-ja ka mbështetur aktivitetet e Rrjetit për Lidership dhe Integritetit të Evropës Juglindore (SELDI) aktiv në fushën e qeverisjes së mirë dhe antikorrupsionit për gati një dekadë. SELDI¹⁰⁵, i udhëhequr nga QMBN, nga janari i vitit 2023 filloi zbatimin e programit të ri rajonal katërvjeçar, me një buxhet të përgjithshëm prej 90.6 milionë denarë, i cili synon të përmirësojë demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e përafrimit me BE-në, duke konsoliduar dhe forcuar ndikimin e shoqërisë civile në politikëbërjen dhe proceset e reformave në rajonin e Ballkanit Perëndimor në fushën e anti-korrupsionit, sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë. Aktivitetet zbatohen në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Përveç mbështetjes financiare të regjistruar në CDAD, është e rëndësishme të përmendet programi për “Partneritet Kundër Korrupsionit: (*Partnership Against Corruption Activity*), i mbështetur gjithashtu nga USAID, i cili filloi zbatimin në tremujorin e tretë të vitit 2023. Ky program do të zbatohet për një periudhë prej 5 vjetësh, dhe buxheti i përgjithshëm është 691.2 milion denarë. Ky program do të mbështesë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe institucionet e saj në trajtimin e korrupsionit dhe do të forcojë transparencën dhe llogaridhënien e tyre. Gjithashtu ndër donatorët më të mëdhenj është Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e cila në vitin 2023 publikoi një thirrje dhe do të jepet në fund të vitit, duke iu referuar Forcimit të Qëndrueshmërisë të Komunave ndaj Korrupsionit në Maqedoninë e Veriut (*Strengthening Municipal Resilience to Corruption in North Macedonia*). Kjo mbështetje arrin në 700.4 milion denarë dhe do të zbatohet në 11 vitet e ardhshme.

103 Përgjigje nga SÇE për Kërkesën për qasje në informata me publik nr. 17-2009/2 datë 14.11.2023

104 Programi “Qytetarët kundër Korrupsionit”

105 Rrjeti Rajonal Kundër Korrupsionit (RRK)

BE-ja monitoron vazhdimisht politikat anti-korrupsion dhe vlerëson problemet e lidhura me korrupsionin dhe efektin e masave anti-korrupsion nga politikanët dhe shoqëria civile. Raporti i progresit i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022 ¹⁰⁶ konstaton se vendi ka arritur një nivel të caktuar përgatitjeje, përkatësisht është mesatarisht i përgatitur për luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, vetëm një vit më vonë, Raporti i Progresit i KE-së për vitin 2023¹⁰⁷ është shumë më shqetësues. Në këtë raport, vlerësimet e progresit janë më të dobëta se vitin e kaluar, kështu që në vend të “një progresi të caktuar”, vlerësimi dominues është nuk ka progres ose progres “i kufizuar”. Në këtë raport, vlerësimet e gjyqësorit dhe lufta kundër korrupsionit janë veçanërisht alarmante si fusha kyçe nga të cilat varet kursi i përgjithshëm i negociatave për anëtarësim në BE. Në fushën e korrupsionit është konstatuar se nuk ka pasur progres dhe në mënyrë të veçantë është shprehur shqetësim serioz për pasojat e ndryshimeve në Kodin penal¹⁰⁸. Këto përfundime justifikojnë përqendrimin në rritje të mbështetjes financiare në luftën kundër korrupsionit nga bashkësia ndërkombëtare, veçanërisht në vitin e fundit.

Organizatave e shoqërisë civile aktive në luftën kundër korrupsionit në periudhën e kaluar mbrojtën vazhdimin e aktiviteteve për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve nga rishikimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC). Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë, si ministri kompetente për zbatimin e konventës së UNCAC në vitin 2021, ka filluar një proces konsultimi me organizatat e shoqërisë civile për konceptimin e një plani me aktivitete për të kapërcyer sfidat e identifikuara brenda ciklit të dytë të rishikimit të zbatimit të UNCAC¹⁰⁹. Megjithëse organizatat e shoqërisë civile dhe palët e tjera të interesit dhe institucionet ishin të përfshira në përgatitjen e këtij plani, nuk ka informacion të disponueshëm për publikun për shkallën e përmblotjes sipas afateve të përcaktuara. QMBN mbetet lider në përpjekjet për zbatimin e UNCAC në vend. Për këtë qëllim, në vitin 2022, organizoi një punëtori kombëtar dy-ditore për zbatimin e UNCAC, në të cilën morën pjesë disa palë të interesuara, përfshirë organizatat e shoqërisë civile, sektori privat, mediat dhe institucionet shtetërore¹¹⁰. Përveç kësaj, QMBN, përmes bashkëpunimit të saj me UNODC, u përfshi në mënyrë aktive në promovimin e nevojës për përfshirjen e sektorit privat në zbatimin e UNCAC duke zhvilluar një “Udhëzues për Përfshirjen e Sektorit Privat” në zbatimin e UNCAC në Evropën Juglindore¹¹¹.

106 North Macedonia Report 2022

107 North Macedonia Report 2023

108 Analizë e shkurtër e Raportit të KE-së për Republikën e Maqedonisë së Veriut 2023, epi

109 pravda.gov.mk/resursi/24

110 <https://mcms.mk/mk/vesti-i-javnost/vesti/2372-lanecot-za-borba-protiv-korupcijata-ne-funkcionira-ako-zatai-barem-edna-od-instituciite-vo-nego.html>

111 <https://www.unodc.org/unodc/ngos/together-against-corruption-at-the-multi-stakeholder-workshop-in-montenegro.html> ; <https://uncaccoalition.org/9th-regional-meeting-for-europe-the-us-and-canada/>

Konkluzione

Kapitulli 1. Niveli i korrupsionit

- Korrupsioni është për herë të dytë në krye të shkallës së problemeve sociale.** Në vitin 2023, 63.5 përqind e qytetarëve (46.1 përqind në vitin 2021) e njohën korrupsionin si problemin që i shqetëson më shumë. Pas korrupsionit, qytetarët identifikojnë paqëndrueshmërinë politike, varfërinë, krimin dhe të ardhurat e ulëta si problemet më të mëdha.
- Ekzistenca e një krize morale në shoqërinë tonë është një faktor kryesor në përhapjen e korrupsionit.** Për 84.9% të qytetarëve të Maqedonisë, ekzistenca e një krize morale në shoqërinë tonë, pasuar nga joefikasiteti i sistemit gjyqësor në luftën kundër korrupsionit, dëshira për pasurim të shpejtë personal të atyre që janë në pushtet dhe mbrojtja e pamjaftueshme e personave që raportojnë korrupsion janë faktorët kryesorë për korrupsionin e përhapur gjerësisht.
- Vërehet një rënie e presionit të korrupsionit dhe përfshirjes në korrupsion.** Presioni korruptiv nga zyrtarët dhe përfshirja e qytetarëve shënon rënie në krahasim me hulumtimin e vitit 2021. Në vitin 2023, 31.3% e qytetarëve ishin të ekspozuar ndaj presionit të korrupsionit, që paraqet rënie për 2.4 pikë të përqindjes në krahasim me vitin 2021, ndërsa 25.5% ishin të përfshirë në korrupsion (në krahasim me 32.9% në vitin 2021). Kjo do të thotë se ka gjithashtu një rritje të rezistencës së qytetarëve ndaj korrupsionit, përkatësisht diferenca midis presionit dhe përfshirjes është 5.8%.
- Korrupsioni mbetet i pandëshkuar në Maqedoninë e Veriut.** Duke marrë parasysh se 25.5% e të anketuarve konfirmuan se ishin të përfshirë në korrupsion dhe nëse kjo përqindje parashikohet për popullsinë e rritur, konkludohet se të paktën 372 mijë e veprave penale janë kryer në fushën e korrupsionit. Nga ana tjetër, në vitin 2022, vetëm 98 persona u dënuan për shpërdorim detyre ose ryshfet, që do të thotë një normë efikasiteti institucional prej 0.026% raste të zbuluara dhe të përfunduara me vendim gjyqësor.
- Analiza e përfshirjes sipas asaj nëse ka pasur presion korruptiv apo jo, shënon përmirësim, krahasuar me vitin 2021.** Në vitin 2023, çdo i pesti qytetar të cilit iu kërkua një kundërsëherbim, dhuratë ose para, e bëri këtë, ndërsa 4,2% e qytetarëve kanë dhënë ryshfet, megjithëse nuk kanë përjetuar presion për ta bërë këtë.
- Ekzistojnë dallime demografike për sa i përket presionit dhe përfshirjes në korrupsion.** Ndryshe nga viti 2021, hulumtimi i fundit tregon se maqedonasit në Maqedoninë e Veriut u përballën me presion shumë më të madh të korrupsionit (37.6%) në krahasim me shqiptarët (22.8%).
- Papranueshmëria e korrupsionit tek qytetarët mbetet në të njëjtin nivel. Dy të tretat e popullsisë së rritur tregojnë intolerancë ndaj korrupsionit,** përkatësisht 62.9% e qytetarëve nuk i miratojnë praktikat korruptive. Projektuar sipas madhësisë së popullsisë, kjo do të thotë se mbi 920 mijë qytetarë e konsiderojnë korrupsionin të papranueshëm, që do të thotë se ekziston një numër i konsiderueshëm i qytetarëve që potencialisht mund të marrin pjesë në shtypjen e këtij fenomeni. Megjithatë, nuk duhet të injorohet fakti se e

projektuar për popullatën e rritur, kjo do të thotë se më shumë se 540 mijë qytetarë besojnë se disa nga praktikat korruptive që ekzistojnë në shoqëri janë të pranueshme.

8. **Ka një rënie të ndjeshmërisë ndaj korrupsionit në krahasim me vitet e kaluara.** Gjegjësisht, pothuajse çdo i pesti qytetar (19.0%) është i ekspozuar ndaj korrupsionit. Inkurajon faktin se numri (39.9%) (38.1% në 2021) i qytetarëve që nuk janë të ekspozuar ndaj korrupsionit po rritet.
9. **Pritje të rritura midis qytetarëve për ekzistencën e presionit të korrupsionit në të ardhmen.** Një shumicë e madhe e qytetarëve ose 82.0% (72.7% në vitin 2021) besojnë se në të ardhmen do të ketë një probabilitet ose probabilitet të lartë të presionit korruptiv. Pavarësisht zvogëlimit të presionit dhe përfshirjes aktuale, fakti që tetë nga dhjetë qytetarë presin një rritje të presionit të korrupsionit tregon pesimizëm të madh dhe më pak shpresë midis qytetarëve se do të ketë një mundësi për përballje me korrupsionin.
10. **Ekziston një përhapje e gjerë e korrupsionit.** Tre të katërtat e qytetarëve (74.4%) besojnë se korrupsioni është i përhapur në mesin e zyrtarëve dhe kjo është një rritje prej pesë pikë të përqindjes krahasuar me vitin 2021.
11. **Ministrat, deputetët, gjyqtarët dhe drejtuesit e partive politike dhe koalicioneve perceptohen si më të korruptuarit.** Korrupsioni ka depërtuar në të gjitha profesionet nga të gjitha segmentet e pushtetit: gjyqësor, ekzekutiv dhe legjislativ. Mbi 80,0% e qytetarëve i konsiderojnë këto funksione si më të korruptuarat. Përveç kësaj, një shumicë e madhe e qytetarëve (mbi 70.0%) besojnë se korrupsioni ka depërtuar në dogana, prokurorë publikë, liderë politikë lokalë, biznesmenë dhe nëpunës tatimorë. Për mësuesit dhe bankierët nga të gjitha 23 profesionet ose grupet e listuara, përkatësisht më pak se 25.6% dhe 29.1% e qytetarëve besojnë se janë të korruptuar.
12. **Qytetarët tregojnë optimizëm më të madh për çrrënjosjen e korrupsionit.** Sa i përket perspektivave për çrrënjosjen e korrupsionit, 50.7% e qytetarëve besojnë se korrupsioni mund të zvogëlohet dhe çrrënjohet në mënyrë të konsiderueshme, por ende ekziston një përqindje e madhe e qytetarëve – 47.4%, të cilët besojnë se korrupsioni nuk mund të zvogëlohet në mënyrë të konsiderueshme.
13. **Ministria e Punëve të Brendshme dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit gëzojnë besimin më të lartë si institucione për trajtimin e korrupsionit.** Qytetarët deklaruan se për përballje me korrupsionin, ata kanë besimin më të lartë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe KSHPK. Në mënyrë kumulative, shumica e përgjigjeve “besim i plotë” dhe “besim i pjesshëm” është 33.9% për Ministrinë e Punëve të Brendshme (2021 ishte 30.3%), përkatësisht 31.2% në KSHPK (2021 ishte 24.2%). **Ka një rritje të konsiderueshme të mosbesimit në Qeveri** ose 74.4% e qytetarëve kanë mosbesim të pjesshëm ose të plotë në Qeveri kur bëhet fjalë për trajtimin e korrupsionit. Përqindja më e madhe e qytetarëve shprehën mosbesim të plotë dhe të pjesshëm në gjykata (76,0%) dhe në Prokurorinë Publike (74,3%).

Kapitulli 2. Politikat kundër korrupsionit dhe kuadri ligjor

1. Dokumenti kryesor për politikat kundër korrupsionit vazhdon të jetë **“Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave (2021-2025)”**, e përgatitur nga KSHPK-ja dhe e miratuar nga Kuvendi në prill të vitit 2021. Sipas raportit vjetor të KSHPK-së për vitin 2022 për zbatimin e Strategjisë Kombëtare, në vitin 2022, 10% e aktiviteteve u zbatuan plotësisht, 35% ishin në vazhdim dhe 55% nuk u zbatuan.

2. Në bazë të kompetencave të veçanta të institucioneve të ndryshme shtetërore, janë përgatitur, miratuar dhe zbatuar **disa politika/strategji kundër korrupsionit**, si më poshtë: Strategjia për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV) (2022-2026); Plani i politikave për qeverisje të mirë në kompetencë të Kabinetit të ZKQRMV-së përgjegjës për politikën e qeverisjes së mirë, me plane vjetore të veprimit, etj. Një strategji e re e transparencës së qeverisë me plan veprimi (2023-2026) po përgatitet gjithashtu në kuadër të kabinetit të ZKQRMV-së përgjegjëse për politikën e qeverisjes së mirë.
3. Legjislacioni kundër korrupsionit vazhdon të jetë gjithëpërfshirës dhe sfida e zbatimit të tij mbetet. Në vitin 2019, u miratua **Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave**, i cili kombinoi korrupsionin dhe konfliktin e interesit. Në pajtim me **Ligjin për kundërvajtje të vitit 2019**, procedura e kundërvajtjes është thjeshtuar. Ndryshimet e shpeshta dhe plotësimet në **Ligjin për punë të brendshme** do të synojnë të nënshtrojnë personelin e policisë në kontrole të rregullta të integritetit profesional. Vitet e fundit kanë hyrë në fuqi edhe ndryshimet dhe plotësimet në **Kodin zgjedhor**. Kuadri ligjor për financimin e partive politike përbëhet nga dy ligje, përkatësisht **Ligji për financimin e partive politike dhe Ligji për qendrat hulumtuese dhe analitike të partive**. Sipas vlerësimit të Komisionit Evropian, kuadri ligjor për financimin e fushatave zgjedhore përmban mjaft lëshime.
4. Ndryshime të rëndësishme u bënë në **Kodin penal** në vitin 2023, i cili u miratua në një procedurë të shkurtuar me flamur evropian. Ndryshimet u pritën me revoltë të madhe nga sektori publik dhe civil. Ndryshimet parashikuan ulje të lartësisë së dënimeve për shpërdorim detyre dhe autorizim dhe shoqërim kriminal, duke zvogëluar kështu kohëzgjatjen e parashkrimit të tyre, ndërsa me ndryshimet u shfuqizuan konfiskimi i zgjeruar i pronës së fituar në mënyrë të paligjshme.
5. **Kuadri ligjor bazë i është nënshtruar ndryshimeve në periudhën e kaluar. Ligji për Gjykatat u ndryshua në vitin 2018 dhe 2019.** Ndryshimet synojnë të kufizojnë mundësinë e korrupsionit në sistemin gjyqësor. Me qëllim të rritjes së transparencës dhe efikasitetit, u ndryshua **Ligji për Këshillin e Prokurorëve Publikë**.
6. **Është hartuar propozim - ligji për konfiskimin e pronës në procedimet civile.** Sipas Qeverisë, ligji do të mundësojë krijimin e një mekanizmi plotësues për të parandaluar me sukses pasurimin e padrejtë dhe konfiskimin e pasurisë që nuk është fituar nga burimet ligjore. Duke marrë parasysh afatin kohor dhe dinamikën e punës së grupit të punës për këtë ligj, Platforma e Organizatave të Shoqërisë Civile për Luftën kundër Korrupsionit u tërhoq nga grupi i punës, duke vlerësuar se dobësitë e gjetura në tekstin e propozuar nuk mund të hiqen në mënyrë thelbësore.
7. Në vitin 2015 u miratua **Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve**, i cili rregullon raportimin e mbrojtur, të drejtat e sinjalizuesve, si dhe veprimet dhe detyrat e institucioneve, përkatësisht personave juridikë në lidhje me raportimin e mbrojtur dhe sigurimin e mbrojtjes së sinjalizuesve.
8. Për shkak të dobësive serioze në lidhje me strukturën ekzistuese të lobimit, Ligji për lobim i vitit 2008 u shfuqizua dhe në vitin 2021 u miratua **Ligji i ri për lobim**, i cili hyri në fuqi në vitin 2022. Ligji zgjeroi kompetencat e KSHPK-së, duke shtuar kompetencën për evidentimin dhe regjistrimin e lobistëve dhe organizatave.
9. **Ligji për prokurimet publike**, së bashku me aktet nënligjore, siguron një kuadër ligjor solid për krijimin e një sistemi modern, transparent dhe efikas të prokurimit publik. Në vitin 2019, u miratua **Ligji për Prokurimet publike në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë**, duke

plotësuar kështu kuadrin ligjor. Në vitin 2021, ky ligj u ndryshua për të siguruar ekonominë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Lidhur me koncesionet, Ligji për koncesione dhe partneritetin publik-privat 2012 (Ligji për koncesionet dhe partneritetin publik-privat) dhe shtatë aktet nënligjore të tij nuk janë plotësisht në përputhje me Direktivën për Koncesionet të BE-së 2014, të cilës i parapriu, por respekton parimet e përgjithshme të BE-së.

10. **Ligji për investimet strategjike në Republikën e Maqedonisë së Veriut**, i miratuar në janar 2020, i cili parashikon një përjashtim nga zbatimi i Ligjit për prokurimin publik, në nenin 4 përcakton projektet e investimeve strategjike dhe projektet që “zbatohen në bazë të marrëveshjeve midis vendeve” dhe konsiderohen projekte strategjike. **Ligji për Përcaktimin e Interesit Publik dhe Emërimin e një Partneri Strategjik për Zbatimin e Projektit të Ndërtimit të Korridorit VIII dhe Pjesës së Korridorit X** të korrikut 2021 përcakton në nenin 4 të tij se dispozitat e Ligjit për prokurimin publik nuk do të zbatohen për dhënien e kontratave në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e projektit.
11. Në Maqedoninë e Veriut, janë aplikuar dy modele aktuale për vlerësimin e rrezikut të korrupsionit. Ky është modeli i vlerësimit të rrezikut të korrupsionit institucional bazuar në vetëvlerësim, i cili është në fuqi që nga viti 2009 në përputhje me Ligjin për kontrollin e brendshëm financiar publik dhe menaxhohet nga Ministria e Financave, dhe metodologjia është përgatitur me ndihmë ndërkombëtare. Modeli i dytë është vlerësimi i rrezikut institucional sektorial bazuar në një vlerësim të jashtëm, nën kompetencën e KSHPK-së.

Kapitulli 3. Praktikë institucionale dhe zbatim i ligjit

1. Në vitin 2020, u promovua një funksion i ri zëvendëskryeministror për luftimin e korrupsionit, zhvillimin e qëndrueshëm dhe burimet njerëzore në Qeveri, në rolin e koordinatorit midis institucioneve që luftojnë korrupsionin. Në vitin 2022, me zgjedhjen e qeverisë së re, ky funksion u riemërua **Zëvendëskryeministër i ngarkuar me politikën për qeverisje të mirë**.
2. Në vitin 2022, u iniciua procedurë disiplinore për përcaktimin e përgjegjësisë nga Prokuroria Publike, pas së cilës u mor vendim për largimin e **ish-kreut të Prokurorisë Publike - NKOK**. Këshilli i Prokurorëve Publikë emëron një prokuror të ri, zgjedhja e të cilit konsiderohet kontradiktore. KSHPK shprehu dyshime në lidhje me kriteret e përzgjedhjes dhe ekzistencën e ndonjë ndikimi.
3. **Kryetari i Këshillit Gjyqësor** u shkarkua nga detyra në prill të vitit 2023. Shkarkimi provokoi një sërë reagimesh dhe kërkesash për rishqyrtim të vendimit.
4. Në periudhën e kaluar nuk ka pasur ndryshime në përcaktimin e mandatit të institucioneve kundër korrupsionit. Në nivel qendror, **KSHPK** vepron si institucion i pavarur i specializuar kundër korrupsionit. KSHPK vepron në përputhje me kompetencat e dhëna në Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit dhe paraqet një raport vjetor për punën e tij në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
5. **Kuvendi** nuk ka komision të specializuar kundër korrupsionit. Një komision hetimor mund të krijohet në Kuvend nëse 20 deputetë (nga gjithsej 120) ngrenë çështje në lidhje me hetimin e përgjegjësisë për korrupsionin, i cili përfshin funksionarë të zgjedhur dhe të emëruar. Në shtator 2023, Kuvendi vendosi ngritjen e një komisioni hetimor për çështjen “Onkologjia”, pas informacioneve për keqpërdorimin me terapinë biologjike për pacientët onkologjikë dhe shitjen e saj, për të cilin rast tani është hapur hetim. Lidhur me funksionimin e Kuvendit, përdorimi i procedurës së shkurtuar me aplikimin e “flamurit të BE-së” duhet

të jetë i kufizuar dhe nuk duhet të përdoret për të shkurtuar konsultimet publike ose për të zgjidhur vështirësitë procedurale në Kuvend.

- Platforma e organizatave të shoqërisë civile për luftë kundër korrupsionit** është përfshirë në procesin konsultativ të hartimit të strategjive dhe ligjeve në fushën e qeverisjes së mirë dhe luftës kundër korrupsionit.
- Lidhur me praktikën e publikimit të propozim - ligjeve në **Regjistrin e Vetëm Kombëtar të Rregulloreve (ENER)**, ende ekziston një praktikë që shumë nga projektligjet nuk janë publikuar në ENER dhe nuk janë në dispozicion për konsultim publik.
- Këshilli Inspektues** është institucioni kyç në sistemin e mbikëqyrjes inspektuese. Në vitin 2019, statusi i tij u ndryshua në organ të pavarur të administratës shtetërore, kompetenca kryesore e të cilit është monitorimi dhe koordinimi i funksionimit të shërbimeve të inspektimit në nivel qendror.
- Sipas raportit vjetor të **ESHR-së**, në vitin 2022 janë kryer 188 revizione, nga të cilat 170 revizione të rregullsisë, 12 revizione të performancës dhe 6 revizione të pajtueshmërisë. Në vitin 2022, ESHR identifikoi 1,242 situata në 223 raporte revizioni.
- Në kuadër të **DAP-së** ka një inspektorat tatimor që kryen mbikëqyrjen e inspektimit mbi subjektet private. Në vitin 2022 janë kryer gjithsej 2,544 kontrolle tatimore (TMA, TMP dhe TVSH). Janë evidentuar parregullsi në 1.215 raste, që paraqet 47,76 % të numrit të përgjithshëm të kontrolleve të kryera. Në vitin 2022, DAP gjeneroi të ardhura totale nga tatimet dhe kontributet sociale nga paga në shumën prej 198.01 miliardë denarë, që përfaqëson 99.67% të të ardhurave totale të planifikuara për vitin 2022.
- Në vitin 2022, **Drejtoria e Doganave** ka kryer gjithsej 165 kontrolle dhe hetime të brendshme. Nga këto, në 51 raste janë konstatuar parregullsi ose mospërputhje me rregulloret doganore.
- Çdo e treta kontratë **për prokurim publik** në vitin 2022 është lidhur në një procedurë në të cilën ka marrë pjesë vetëm një kompani. Numri mesatar i ofertave për të gjitha procedurat e prokurimit publik për vitin 2022 është 3 oferta për tender. Mungesa e konkurrencës çon në një rritje të rrezikut në tendera ku nuk është marrë vlera më e mirë për para. Çmimi më i ulët është përdorur si kriter për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme në procedurat e tenderimit në 94% të tenderëve të zhvilluar në vitin 2022. Nevojapër negociata pa publikim paraprak të shpalljes u ul në 6.6% në vitin 2022, nga 8% në vitin 2021.

Kapitulli 4. Gjyqësori dhe lufta kundër korrupsionit

- Në përgjithësi, gjyqësori në Maqedoninë e Veriut përballet me **sfida** në lidhje me ruajtjen e besueshmërisë, ndarjen e lëndëve, pajisjet e pamjaftueshme teknike dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, të cilat kërkojnë reforma gjithëpërfshirëse për funksionimin e tij efektiv dhe transparent.
- Sipas të dhënave nga ESHR-ja në lidhje me veprat penale kundër detyrës zyrtare, **numri më i lartë i aktakuzave (147) dhe dënimeve (98) është regjistruar në vitin 2022** krahasuar me katër vitet e fundit.
- Ndryshimet në Kodin penal** prekin pothuajse të gjitha akuzat nga çështjet më të mëdha të ish- PSP-së, përkatësisht për 14 lëndë gjyqësore, për të cilat janë akuzuar më shumë se 80 persona, do të ketë parashkrim absolut për ndjekje penale.

Kapitulli 5. Korrupsioni dhe ekonomia

1. **Punësimi informal si një segment i ekonomisë gri**, sipas ESHR-së, ka rënë si në vlerë absolute ashtu edhe si përqindje e punësimit formal, nga viti 2008 e në vazhdim, kështu që në vitin 2021 dhe 2022 nga gjithsej 100 të punësuar në vend, në mënyrë informale janë punësuar 12 persona.
2. Sipas të dhënave të hulumtimit, **86.8% e të anketuarve kanë një kontratë me shkrim** me punëdhënësin e tyre, dhe **33.0% e tyre marrin një pagë më të lartë se ajo e rregulluar në kontratë**. Megjithëse një pakicë e të anketuarve (4.5%) deklaruan se nuk kishin kontribute të paguara në vendin e punës, **22.2% thanë se kontributet e tyre paguheshin në bazë të një page më të ulët ose në bazë të pagës minimale ligjore**, edhe pse kompensimi aktual financiar për punën e tyre ishte më i lartë.
3. Në vitin 2023, u miratua **Strategjia e re për Formalizimin e Ekonomisë Joformale (2023-2027) dhe Plani i Veprimit**, i përgatitur përmes bashkëpunimit ndër-sektorial, dhe bazuar në një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e ekonomisë joformale. Gjithashtu, Qeveria me vendim krijon Këshillin Kombëtar për Formalizimin e Ekonomisë Informale i përbërë nga 20 anëtarë, përfaqësues të nivelit më të lartë nga institucionet, kompetencë e të cilëve janë aktivitetet për reduktimin e ekonomisë informale.

Kapitulli 6. Shoqëria civile në luftën kundër korrupsionit

1. Në vitin 2022, **Ligji për shoqata dhe fondacione (LSHF) u ndryshua** me dorëzimin e propozim - ndryshimeve nga deputetët që u pranuan me procedurë të përsheptuar. Ndryshimet e miratuara ndalojnë shoqatat dhe fondacionet civile të përdorin emra dhe pseudonime të lidhura me fashizmin, nazizmin, gjenocidin, Rajhun e Tretë, etj.
2. Megjithëse ndryshimet në disa ligje rritën shkallën e mbrojtjes juridike të gazetarëve, vitin e kaluar **u identifikuan një numër sulmesh, kërcënimesh dhe disa frikësime të gazetarëve**. Gjegjësisht, MPB regjistroi dhe hapi hetim për 17 raste të sulmeve ndaj gazetarëve dhe SHGM regjistroi 14 incidente që përfshinin gazetarë.

Kapitulli 7. Bashkëpunim ndërkombëtar

1. **Institucionet ndërkombëtare në dy vitet e fundit kanë rritur ndjeshëm mbështetjen financiare** në fushat e qeverisjes së mirë dhe anti-korrupsionit, të cilat përveç forcimit të institucioneve shtetërore si aktorë kryesorë anti-korrupsion, synojnë gjithashtu të rrisin angazhimin dhe bashkëpunimin në luftën kundër korrupsionit të të gjithë aktorëve kryesorë.



2023

RAPORT

**PËR VLERËSIMIN
E KORRUPSIONIT
NË MAQEDONINË
E VERIUT**